

Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (36). PRILL 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO



"Risku" sh.p.k.
Market "Ken"

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

OPINION

Arsimi duhet të parandalojë krizat

Nga: **XHAFFER SEITI** - FAQE 5

SHENIME

Si në shtëpinë time...!

Nga: **VESEL HOXHA** - FAQE 10

OPINION

"Shëngjergji"- festë popullore

Nga: **AHMET ÇAUSHI** - FAQE 4

MJEDISI

Shenjtori i gjelbër

Nga: **HAKI KOLA** - FAQE 12

"Dibra vjen në Kamëz"

Këshilli Bashkiak i Kamzës emëron 34 rrugë me emrat e fshatrave dhe vendeve nga qarku i Dibrës

FAQE 4


BOTIME

Mereme Suli, "Dialog me lulen"



Nga: **VIRON KONA** - FAQE 16

"Për prozën e Kadaresë", një libër i ri nga Shaban Sinani



FAQE 13



"Pasuria me tre emra"

Nga **SHPËTIM CAMI**

Rrethi i Bulqizës shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe bën pjesë në qarkun e Dibrës. Deri në vitin 1992 Bulqiza ka qenë pjesë e rre-

thit të Dibrës, ndërsa që nga ai vit është rreth me vete.

Rrethi ka tetë njësi administrative: Bashkinë e Bulqizës dhe shtatë komuna, si: Fushë Bulqizë, Martanesh, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren,

Trebisht.

Rrethi përbëhet nga 62 fshatra. Nga pikëpamja krahinore ndahet në tri pjesë: Bulqiza, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël dhe Golloborda.

(Vijon në faqen 8)

17 vjeçari **BLEDAR KAZIA** sjell shpikjen e re:

Energji nga tastiera e kompjuterit



165 VJET MË PARË

Protagonistët e betejës së Drinit 1844

Nga: **SAKIP CAMI** - FAQE 11

VEPRIMTARI

Vlerësohet Cirku i Peshkopisë

Nga: **S.STAFA, H.BRUÇI** - FAQE 9

VENDIMI

Burgim të përjetshëm për vëllezërit Duka

Nga: **BEQIR SINA** - FAQE 3

ME SHKAS

Tadiqi vjen në Kosovë, Sejdiu s'guxon në Mitrovicë

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 4,6

vendimi

Gjykata e Camdenit në Nju Xhersi ka dënuar me burgim të përjetshëm dy vëllezërit Duka, për komplot ndaj bazës ushtarake Fort Dix në afërsi të Nju Xhersit.

Burgim të përjetshëm për vëllezërit Duka

RAPORT SPECIAL

nga BEQIR SINA, Nju Jersi

CAMDEN, NEW JERSEY: Gjykata vendosi burgim të përjetshëm për Dritan Duka (28), Elvir Duka (23), Shain Duka (26). Të tre emigrantët janë me origjinë nga Dibra e Madhe (shati Spase) dhe një kohë të gjatë po jetonin dhe punonin në SHBA.

Në Shtetet e Bashkuara, një gjykatës federal dha dënime të gjata burgimi edhe për dy personat e tjerë të shpallur fajtorë për komplot për vrasjen e personelit ushtarak amerikan në një bazë ushtarake të Nju Xhersit.

Gjykatësi dënoi Mohamed Shnewer, i lindur në Jordani, me burgim të përjetshëm plus 30 vjet për rolin e tij në komplotin për të sulmuar bazën Fort Diks në Nju Xhersi. Një tjetër person, Serdar Tatar, i lindur në Turqi, u dënua me 33 vjet burg. Akuza i ngarkoj ata për komplot ndaj një baze ushtarake amerikane, Fort Dix, e cila merret me përgatitjen e rekrutve, në tetor të vitit të kaluar janë shpallur fajtorë nga një juri prej 11 vetash.

Gjatë procesit të hetimeve janë marrë në pyetje 50 dëshmitarë, ndër të cilët më vendimtare ishin dëshmitë e dy emigrantëve shqiptarë Agron Abdullahi dhe Besnik Bakalli. Akuza me 26 faqe është e mbështetur nga një aktakuzë, e lexuar që në ditën e parë të arrestimit të tyre një vit më parë. Në rastin e të pandehurve për sulmin kundër Fort Dix, shpallja e tyre fajtorë mund edhe t'i çojë të akuzuarit deri në burgim të përjetshëm.

Avokati i kësaj çështjeje e hedh përsëri poshtë akuzën, duke thënë se klientët e tij nuk kanë pasur në asnjë mënyrë si "qëllim ndonjë komplot kundra bazës ushtarake në Fort Dix, për të cilën akuzohen, po t'u referohemi provave. Të përfshirë në këtë çështje është edhe një informator i FBI-së, me origjinë shqiptarë.

Emigrantët u arrestuan në vitin 2007 pas një survejimi të FBI dhe CIA. Gjatë procesit gjyqësor që ka zgjatur tetë javë, prokurorët kanë përcaktuar se bëhet fjalë për radikalë islamik dhe se ata kishin planifikuar sulm të organizuar për të vrarë ushtarë amerikanë në bazën amerikane ushtarake Fort Dix që gjendet 60 kilometra në largësi të Nju Xhersit.

GYKIMI DHE DËNIMI :

Shain Duka ka qenë i dënuar parë që iu shqiptua dënimi me burgim të përjetshëm plus 30 vjet, me akuzën për rolin e tij në një komplot, që siç tha gjykatësi i kësaj çështjeje për të vrarë ushtarë në Fort Dix.

Ai është njeri nga të tre vëllezërit nga Dibra e Madhe, që jetojnë në Cheery Hill, dhe që u dënuan në një gjykim historik mbrëmë vonë nga një Gjykatën Federale në Camden. Gjyqi i tyre, zagjati më shumë se një vit dhe konsiderohet si gjyqi më i gjatë në historinë e llojit të kësaj akuaze.

Elvir Duka u dënua me burgim të përjetshëm dhe Ditran Duka gjith-



ashtu mori jetën plus 30 vjet.

Ata kanë gjasa që të dërgohen për të vujatur dënimin në burgje të veçanta të sigurisë super-maksimale burgjet federale, thanë zyrtarët në kushte të anonimitetit. Për dy vitet e fundit, ata kanë qenë në paraburgim në Qendrën Federale të Paraburgimit në Filadelfia.

Vëllezërit, Duka, së bashku me dy të tjerët, një turk dhe një jordanez, ishin bashkë-pandehur, dhe janë dënuar në dhjetor 2008, po me të njëjtin dënim që dha Gjykata dje, edhe nga një juri prej 11 vetash, për konspiracion, akuza: "për të vrarë ushtarët e shërbimeve me uni-

formë në një komplot ku shërbejnë e serviten rekrutët në bazën ushtarake Fort Dix. Bazë e cila sipas akuzës që qe ngritur ndaj tyre e identifikuar si një objektiv që të ishte i mundur për sulm".

Megjithse gjatë shqiptimit të dënimit gjykatësi Kugler, i "liroj ata nga akuzat për tentativë vrasjeje," nuk ndikojë aspak në marrjen e vendimit për burgim të përjetshëm plu 30 vjet.

Dritan Duka dëshmoi gjithashtu, gjatë gjyqimit dje se ai ishte i shpalljes" Krejtësisht të pafajshëm" dhe se gjyqi në këtë rast nuk do të kishte asnjë llojë vendimi të këtillë

"pa gënjeshtër dhe fantasis e shpifura ndaj e tij bashkë me vëllezërit nga informatorët",

Shnewer dhe bashkë-pandehuri, tjetër Serder Tatar, janë planifikuar t'u dënuar sot.

Avokatë mbrojtjes të tre vëllezërve Duka, jo vetëm në gjyqin e zhvilluar dje, por prej se kur ata u arrestuan kan argumentuar se tre vëllezërit Duka kurrë nuk ka pasur në mendje ndonjë komplot dhe çdo propozim ka qenë një "mendim" i avancuar duke u paguar informatorëve shuma të mëdha financiare për përfitime personale, domethënë edhe shkelje ligjore në statusin



Ferik Duka : "Nëse fëmijët e mi do të ishin fajtorë, atëherë ata nuk do të ishin më fëmijët e mi. Por ata janë të pafajshëm", - deklaroi ai.

e Shtetet e Bashkuara të Amerikës." tha avokati vëllezërve Duka

Avokati i Dritan Dukës u shpreh se klienti i ti nuk kishte rol qendror në këtë komplot dhe se ai ishte futur në grackë. Por për akuzën, 30-vjeçari do të ishte një prej personave që do të qëllonte me armë, si një ushtar i Zotit". Për avokatin e shqiptaro maqedonasve, ata nuk janë ushtarë të xhihadt. Ata janë thjesht fetarë të devotshëm dhe familjarë punëtorë. I ati i dy vëllezërve u shpreh se "nëse fëmijët e tij do të ishin fajtorë, atëherë ata nuk do të ishin më fëmijët e tij. Por ata janë të pafajshëm", - deklaroi ai.

SHQIPTARËT JANË POPULLI MË PRO AMERIKAN NË BOTË

CAMDEN, NEW JERSEY: Një jehonë e paparë i është bërë arrestimit të katër shqiptarëve nga mediat serbe, greke dhe ruso file prej arrestimit dhe deri dje me dënimin e tre shqiptarëve, Dritan Duka, 28 vjeç, Shain Duka, 26 vjeç, Elvir Duka, 23 vjeç, që të tre shqiptarë emigrantë nga Dibra e Madhe (Spase). Kjo vlen, pa përmendur artikujt dhe komentet on-line, ku sidomos ku janë të përfshirë edhe personalitete, por dhe njerëz të thjeshtë serbë dhe serbo-amerikanë, grek dhe rusë, që janë ende duke i akuzuar shqiptarët se kanë prirje ekstreme islamike. Kaq të forta janë këto komente, sa kur filluan këto sule kundër shqiptarëve, u desh që edhe një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit, ta konsideronte, arrestimin e të pestëve si një "grup të izoluar" dhe që vepronte në mënyrë "të pa kuptueshme", pa pasur lidhje me grupe të ndryshme terroriste.

Por as kjo deklaratë nuk e "zbuti" qëndrimin e këtyre komentuesve. Mjafton një kërkim i thjeshtë për komplotin siç e quan media amerikane komplortin e planifikuar në "Fort Diks", dhe vërehet lehtësisht se pjesa dër-



Ferik Duka, nga e majta, babai i tre vëllezërve Duka dhe gruaja e tij, Zurata, në qendr, ulur me anëtarët e tjerë të familjes në një konferencë shtypi pasi tre djemtë e Duka, Dritan, Shain dhe Elvir u dënuan me burgim të përjetshëm në gjykatën federale në Camden, NJ, të martën, 28 prill, 2009. Dritan Duka, 30 vjeç, dhe vëllai i tij, Shain Duka, 28, u dënuan me burgim të përjetshëm plus 30 vjet dhe Elvir Duka, 25 vjeç, u dënua me burgim të përjetshëm për bindjet e tyre për komplot për të vrarë personelit ushtarak në Fort Dix në New Jersey.

rmuese e artikujve, por dhe e komenteve për këtë çështje, i takon kategoris serbe, greke dhe ruso file, që përpiqet të përshtatë

në një mënyrë, a në një tjetër këtë ngjarje në kontekstin e "terrorizmit islamik", që sipas tyre gëlon në mesin e shqiptarëve. Gjithse-

si, përtej këtyre komenteve, është fakt se shqiptarët janë populli më pro amerikan në botë.

Shqiptarët janë populli më pro amerikan në Botë. Kjo është dëshmuar shumë herë gjer më sot. "Jemi mahnitur, unë dhe presidenti Bush, nga pritja madhështore që na bëri populli shqiptarë. Asnjëherë, në jetën time nuk kam parë kaq shumë njerëz të shprehin gëzimin e tyre për presidentin e SHBA-ve", theksoi ish- zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Diana Perino. Lidhjet shqiptaro-amerikane janë të sinqerta që dëshmojnë se Amerika do të qëndrojë gjithmonë përkrah Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi. "Ju vetëm që i treguat botës se jeni populli më pro Amerikan në botë, por keni bërë për vete edhe SHBA-të e popullin amerikan", theksoi Perino. Lidhjet tradicionale tashmë janë të forcuara dhe të përhershme. "Ju keni forcuar edhe më shumë lidhjet, keni forcuar miqësinë me SHBA-ës". Një rrugë në Tiranë, e mori emrin "Rruga Presidenti George W. Bush", theksoi Perino në konventën e republikanëve të rajonit Westchester dhe New York-ut.

Vendosja e një përmendoreje në Peshkopi është vlerësim për Skënderbeun dhe popullin e Dibrës, sepse këtu, në këto troje, filloi jeta e tij, ky popull u bë mbështetja e parë dhe se këtu vazhduan e u fituan thuajse të gjitha luftërat.

“Shëngjergji”- festë popullore, apo...!

Nga: Ahmet ÇAUSHI

Kjo festë është emërtuar “shëngjergji” ndosh ta mijëra vjet pas fillimit të saj. Edhe në periudha kohe të panjohura prapambetjeje e të padokumentuara me shkrim, njerëzit kanë festuar ditë gëzimi e shprese. Ndër ditët, që kanë shpresuar të sjellë gëzim e shpresë për njerëzit, lidhen me natyrën që i rrethonte, me ndërrimin e kohës, me ardhjen e të ngrohtit e gjelbërimit, me të vjelat etj. Dita e Verës i gëzonte njerëzit, sepse dita kishte filluar të zgjatej, ngrohtësia e diellit ishte rritur, gjelbërimi zbukuronte ambientin, fillonin edhe punët për vitin e ardhshëm, sigurohej më shumë ushqim për bagëtinë etj. Në këtë periudhë dimri rezervat ushqimore ishin në mbarim për njerëzit dhe kafshët, prandaj pritej me gëzim Dita e Verës si ditë e shpresës së mirë. Kjo ditë koinçidon me ekuinoksin e pranverës, pra është edhe një përlllogaritje e çuditshme e këtij ekuinoksi në ato kohë të hershme. Edhe Nevruzi është ditë pranvere, por e festuar rreth 5000 vjet më parë në Persi. Këto ditë njerëzit bënin edhe pastrimin e ambienteve të shtëpive dhe rreth e qark tyre. Gratë lyenin shtëpitë me “botë”, kurse djemtë e vajzat e vogla mblidhnin papastërtitë e lëna nga dimri si copëra kranshesh, kashta misri të lëna nga bagëtitë, ferrat rreth shtëpisë dhe i digjnin Natën e Verës. Ditët pranë Ditës së Verës dhe Dita e Verës ishin të mbushura me aktivitete që u jepnin bukuri të veçantë atyre ditëve.

Rreth një muaj e njëzetë ditë më vonë festohej “Shëngjergji”. Megjithëse të ftohtët e madh kishte kaluar, herë pas here frynin erëra të ftohta, sidomos në ditët e “plakave”, binin shira dhe borë, pra të ftohtët nuk kishin ikur. Populli thoshte “Kërcurin e madh ruaje për natën e Shëngjergjit”. Prandaj ndarja e vërtetë e periudhës së ftohtë vazhdonte deri në fillim të majit, në natën e Shëngjergjit. Tek brezat e

Vendosja e një përmendoreje në Peshkopi është vlerësim për Skënderbeun dhe popullin e Dibrës, sepse këtu, në këto troje, filloi jeta e tij, ky popull u bë mbështetja e parë dhe se këtu vazhduan e u fituan thuajse të gjitha luftërat.

rinj vinte gojëdhëna se dikur kishin shkuar me delet në bjeshkë. Natën e Shëngjergjit i kishte zënë i ftohti i madh e ata kishin ngrirë, ishin bërë gurë e këta gurë akoma na qenkan në bjeshkë. Mijëra vjet më parë është llogaritur kjo kohë. Vërtetë është një ndarje si me thikë e kohës së ftohtë me të ngrohtin që vjen pas kësaj dite.

Njerëzit e festonin të gjithë këtë ditë. Të gjithë ruanin qengjin më të majmë për këtë ditë. Të pasur e të varfër nga një qengj e pritnin. Javë më parë fillonte gara se kush do të majmte më shumë qengjin e kësaj feste. Nga kjo ditë e më pastaj ndalohej bagëtia të kullonin në arat që do të mbilleshin dhe në livadhe. Anash rrugëve bëhej rrethimi me gardh. Në prag të kësaj dite bëhej pastrimi i kullotave dhe i pyjeve pranë qendrave të banimit. Këto mbeturina si krah të thara pyjesh, shkurre të dala në kullota e mbeturina të tjera bëheshin mullar dhe digjeshin në këtë natë të shënuar. Atëherë bëhej ky pastrim kullotash e pyjesh pa farë shtyse nga askush. Shkonin me dëshirë dhe askush nuk mungonte. Një venitje e tillë e një pune të tillë nuk duhej lënë në harresë si vjetërsirë. Në këtë ditë, djem e vajza të ndarë festonin nëpër livadhe e lëndina të zbukurara me gjelbërimin natyror. Këndonin e kërce-

nin. Përmendnin më të bukurën pa përmendur emra. Lojrat më të pëlqyera ishin “Jesir”, “Kala dibrance” dhe lojra të tjera me topa lecke. Këto lojra kishin vlera patriotike. Ato zinin robër të armikut dhe lironin vëllezërit e tyre të zënë robër nga armiku. Ndërtinin kala dhe provonin ta ruanin dhe me çdo kusht ta merrnin atë. Këto ishin shkolla të vërteta patriotike dhe vëllazërimi. Kjo fillonte që nga moshë 7-8 vjeçe e vazhdonte deri tek të rriturit. Kjo festë shumë e hershme vjen nga ilirët e ndoshta shkon më tej në kohë.

Rreth 300 vjet pas fillimit të erës së re, kësaj festë ia lanë emrin “Shëngjergj”. Shëngjergji është emërtim kishtar ortodoks. Në vitin 275 të erës së re në Kapadoni lindi në një familje të krishterë një djalë e ia vunë emrin Gjergj. I ati u martirizua nga romakët si përkrahës i Krishtit. Gjergji, kur ishte ushtar në ushtrinë romake, u dallua si luftëtar i zoti, prandaj mori titullin e princit. Ai u martua me një palestinezë nga Lida. Në atë kohë Gjergji bëri një deklaratë për mbrojtjen e Krishtit, që asokohe luftohej shumë nga perandorët romakë, prandaj u dënua rëndë. Ai u vu në kryq dhe e duroi, u gjakos duke u tërhequr zvarrë e nuk u dorëzua. Më tej, vazhdon dokumenti kishtar, engjëlli e liroi Gjergjin dhe ia shëroi plagët. Për këtë qëndresë i dhanë emërtimin e shenjtërisë “Shën Gjergji”. Ata kërkuan data të zgjedhura për ta përjetësuar këtë figurë kishtarë. Në vende të ndryshme si në Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Danimarkë, Angli etj ka patur data të ndryshme dhe emërtime vendesh. Në Mal të Zi është një kodër që quhet “kodra e Shën Gjergjit”. Tek ne kërkuar festën më popullore për t’i dhënë jetë edhe shenjtët të tyre. Kështu është vepruar edhe me Jezusin. Askush nuk e di lindjen e tij. Katolikët e festojnë më 25 dhjetor. Populli ynë dhe të tjerët e kanë festuar këtë ditë mijëra vjet më parë. 25 dhjetori shënon ditën e kthimit të diellit nga vera. Në

të vërtetë Isai ka lindur në pranverë. Është vepruar kështu për t’i bërë këto figura të rëndësishme fetare sa më popullore. Pra, përfundimisht, Shëngjergji është figurë kishtarë ortodokse.

Po me heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, a ka lidhje kjo festë? Jo, aspak jo! Skënderbeu nuk ka nevojë për t’ia rritur vlerën me figura të tjera. Ai nuk ka lindur më 6 maj. Jeta e tij ka qenë e mbushur me atdhedashuri, guxim e trimëri për të luftuar kundër pushtuesve osmanë e venedikas. Ai ka luftuar, por edhe ka lidhur marrëveshje edhe me turq, edhe me venedikas etj. Feja e Skënderbeut nuk dihet. Ai lindi në një familje “politikane”, që fenë e përdori edhe për politikë. Edhe vetë që musliman e u bë synet në moshë të rritur. Vlerën e Skënderbeut nuk e rrisin gënjeshttrat dhe mashtrimet, siç është edhe kjo e lindjes së tij. Atë e rrisin bëmat e tij për At dheun e tij, për Shqipërinë. Gënjeshttrat e mashtrimet janë më të rrezikshme për asgjësimin e jetës së heroit tonë kombëtar se sa mitet, sepse mitet kanë diçka edukative apo edhe të vërtetë, nga që, në një farë mënyre, ata flasin për trimëritë, mençurinë apo forcën e tij. Prandaj nuk duhet gabuar dhe as duhet pranuar një emërtim i tillë. Skënderbeu, e jo Shën Gjergji i kishës ortodokse, udhëhoqi popullin tonë në shekuj për të mbrojtur vendin, për të fituar lirinë kur na e rrëmbyen të tjerët, për t’u bashkuar si vëllezër të një kombi dhe do të na udhëhoqë tërë jetën.

Vendosja e një përmendoreje në Peshkopi është vlerësim për Skënderbeun dhe popullin e Dibrës, sepse këtu, në këto troje, filloi jeta e tij, ky popull u bë mbështetja e parë dhe se këtu vazhduan e u fituan thuajse të gjitha luftërat.

Pas pranimit të fesë Islame, festimi i Shëngjergjit nuk u harrua. Ai iu kthye të vërtetës fillestare. U festua e në përmasa të vogla vazhdon të festohet larg besimeve fetare.

Me shkas



Nga REXHEP TORTE

Vizita e kryetarit serb Boris Tadiq fundmua jin që shkoi në Manastirin e Deçanit me rastin e Pashkëve Ortodokse përmes lejes së kryeministrit Thaçi të nxitur nga presioni diplomatik ndërkombëtar, me kusht që të ishte vetëm vizitë ceremoniale fetare dhe që Tadiq të mos jepte deklaratë politike që janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, se për ndryshe nuk do t’i lejohet më që të hyjë në Kosovë, me të drejtë shkatoi reagime. Përkundër kësaj Tadiq i shoqëruar nga Goran Bogdanoviq, ministër serb për Kosovën, me të hyrë në Manastirin e Deçanit e ka cilësuar Kosovën pjesë të Serbisë, duke shtuar, se kjo është Dita e vuajtjes dhe shpresës për të gjithë njerëzit që i përkasin krishtërimin. Duke dhënë mesazhin e paqes për serbët e shqiptarët që gjoja jetojnë në tokën serbe, se pa paqe nuk mund të sigurojmë jetesën tonë. Pa drejtësi në paqe nuk mund të kemi jetë normale. Kjo është ditë kur nuk duhet të ketë mllëf e urrejtje”. Duke harruar fare se e para gjë që duhej

Tadiqi vjen në Kosovë, Sejdiu s’guxon në Mitrovicë

të thoshte në këtë ceremoni fetare, do të ishte kërkesa për një falje publike drejtuar shqiptarëve të Kosovës për krimet e bëra shekullore ndaj shqiptarëve. Përkundër dhunës dhe mizorive serbe ndaj shqiptarëve ai dha mesazhin e tij paqes për serbët e shqiptarët që gjoja jetojnë në tokën serbe, se padrejtësi në paqe nuk mund të ketë jetë normale, duke harruar fare instrumentalizimin nga Beogadi të serbëve të Mitrovicës, Veriut të Kosovës dhe të serbëve tjerë brënda Kosovës, për të mos iu bindur ligjeve dhe institucioneve të Kosovës dhe për pamundësinë që presidenti Fatmir Sejdiu tëq mund ta vizitojë veriun e Kosovës.

Kjo deklaratë e tij u bë në lidhshmëri edhe me Deklaratën serbe drejtuar Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë në Hagë, për të kundërshtuar Ligjshmërinë e Pavarësisë së Kosovës dhe me deklaratën pompoze të ministrit Jeremiq, se kanë dërguar argumente bindëse dhe se do të kenë mbështetjen e shumë shteteve për të kundërshtuar ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës”.

SERBIA AGRESORE MË AKTIVE SE KOSOVA VIKTIMË

Dhjetë vite pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe pas dhënies fund të dhunës dhe mizorive serbe nëpërmjet Luftës së UÇK-së dhe ndërhyrjes së NATOS kundër forcave ushtarake e policore serbe, që përdorën gjenocidin dhe eksodin serb ndaj shqiptarëve për të zbra-

zur Kosovën nga shqiptarët, analizat tregojnë se me përjashtime të vogla, siç janë aktivitetet e Vetvendosjes, të ndonjë libri apo pjesë skenike, tregojnë se institucionet dhe përfaqësuesit e të gjitha fushave, u kapluan nga një gjumë magjik vetëënaqësie. Për krimet serbe nuk duhet rreshtur kurë që ato të prezentohen sa më fuqishëm. Ditëve të fundit kur u aktualizua çështja me kërkesën serbe drejtuar Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë, filluan edhe debatet e nxehta nëpër medimeve elektronike dhe të shkruara kosovare. Ministri i jashtëm i Kosovës Hyseni deklaroi se, ekipi ligjor në krye me Majkël Vud ka përmbledhur të gjitha faktet dhe argumentet e pakontestueshme që dëshmojnë legjitimitetin e Pavarësisë së Kosovës. Ndërkaq opozita kosovare fajëson qeverinë e Kosovës pse nuk i ka përfshirë përfaqësuesit kosovarë për ta mbrojtur legjitimitetin e shtetit të Kosovës dhe se Qeverinë e Kosovës e ka përfshirë korrupsioni. Në se kjo është e vërtetë, atëherë mund të themi se është bërë lëshim i madh, sepse asnjëherë një i huaj përkundër dëshirës dhe gatishmërisë së tij, nuk mund ta artikullojë çështjen kosovare më mirë se kosovari që e ka ndje në shpinën e tij dhunën serbe, dhe e dyta është neveritëse, e pakuptueshme, e pafalshme dhe e dënueshme, që pas kaqë vuajtjeve, vrasjeve e djegieve në Kosovë, të mund të ketë qeveritarë të përfshirë në korrupsion.

ANEKSIMI SHEKULLOR SERB MBI KOSOVËN

Nuk është e tëpërt që edhe njëherë t’i bëjmë të njohura për opinion të dhënat historike të pakontestueshme që flasin qartë, se Serbia ka qenë shtet në miniaturë si Sanxhak i Beogradit, se zgjerimi i Serbisë është bërë gjithnjë nëpërmjet okupimeve të trojeve të huaja me vrasje e djegie, e më së shumti të trojeve shqiptare. Këto të dhëna historike e shkencore, dëshmojnë edhe nëpërmjet Faksimilit të hartës së Enciklopedisë Ruse të vitit 1817, ku shihen qartë kufijtë realë të Serbisë në atë periudhë dhe në vitet 1804, 1810, 1812, 1815, 1820, 1867, që janë shënuar në brendinë e kësaj harte. Kufijtë e sotëm të Serbisë, ku përfshihet edhe Kosova, janë arritur vetëm nëpërmjet ekspeditave të përgjakshme dhe aneksimave serbe të trojeve të fqinjëve.

MIZORITË SERBE NDAJ SHQIPTARËVE

Mediat gjatë luftës së fundit në Kosovë kanë shkruar se, » Në një fshat të Kosovës jeton një nënë shqiptare, si edhe mijëra nëna tjera shqiptare zemërplagosura, shpirti i të cilës do të mbetet gjithnjë i trishtuar. Jo pse në luftën e padrejtë që imponuan serbët në Kosovë, ia vranë burrin, djalin, para syve ia përdhunuan vajzën e re, por i bënë edhe gjëmën më të madhe që s’do ta kishte bërë as soji i bishave më të tërbuara.

(Vijon në faqen 6)

Një vështrim i Prefektit të Dibrës mbi gjendjen ekonomike globale dhe vështrimin konkret mbi arsimin në Dibrës. Konkluzioni: “Një mësues pa personalitet apo me moral të cunguar i sjell edukimit një dëm të pallogaritshëm”



Nga: **XHAFER SEITI**
PREFEKT I QARKUT DIBER

E dhe për të bërë një shkrim apo për të hedhur në letër ide të përpunuara në kokë për vite me radhë, duhet një moment, një nxitje, një moment i caktuar .

Kjo krizë ekonomike po bën që drejtuesit e administratave dhe qeverive të shteteve të planetit të mendojnë për arsimin, të rrotullohen rreth tij. Pse?! Sepse çdo ditë e më tepër gjithkush po e kupton se arsimi është bazë e transformimit, i cili sjell mirëqenien, atë mirëqenie për të cilën luftojnë të gjithë dhe po të gjithë e duan të përsosur. Po pikërisht kjo mirëqenie është funksion i të panjohurave të sotme . Po cilat janë të panjohurat ?! Si zbulohen?! Ç’mendim kanë për këtë psikologët, biologët, shkencëtarët, teknologët, ç’mendim ka një masë e tërë që përpiqet për të njëjtin qëllim, rritjen e mirëqënies dhe intensifikimin e gradualitetit të kësaj rritjeje.

Presidenti i SHBA Barak Obama në fjalën e tij më 20 janar 2009 për arsimin midis të tjerave tha: “ ... shkollat tona janë shpesh dështake dhe çdo ditë që kalon, sjell fakte të reja mbi mënyrën iracionale të përdorimit të energjisë, mënyrë që forcon kundërshtarët tanë dhe kërcënon planetin. Këta janë tregues të krizës, të dhëna dhe statistika”.

Ta konkretizojmë disi problemin, të sjellim e ballafaqojmë fakte e nëpërmjet tyre të ballafaqojmë dhe ato që ndodhin në arsim, pse ndodhin e si duhet të bëhen më mirë. Në këndvështrimin si prefekt i qarkut Diber për një periudhë prej tre vjetësh e gjysëm, falë dhe angazhimit tim konkret, kryefjala e analizave dhe e përqëndrimit të punës ka qenë, është dhe do të vazhdojë të jetë ajo e problemeve të arsimit dhe edukimit të brezit të ri, natyrisht duke mos anashkaluar asnjëherë dhe problemet e tjera jetike.

Në axhendën e punës së Prefektit janë të shumta problemet që ka pasur e vazhdon të ketë qarku i Dibrës dhe kjo ka bërë që në përgjithësi nga drejtuesit e titullarë të synohet për të ndjekur e për t’u marrë më shumë me institucionet që janë të lidhura me problemet ekonomike apo të shërbimeve, që gjykohej se ndikojnë në përmirësimin e jetës në komunitete.

Për arsimin dua të bëj të qartë se në konsiderimin tim, nuk mund të punohet me ritmin dhe tempin e duhur, po qe se drejtuesit e Drejtorive Arsimore Rajonale, të zyrave arsimore në rrethe , të shkollave apo vetë mësuesit nuk janë njohur ndër të tjera dhe me programin ambicioz

Arsimi duhet të parandalojë krizat

të Qeverisë në fushën e arsimit. Ky program duhet reklamuar bindshëm jo për të bërë politikë, por për të mirë të vetë arsimit dhe mbarëvajtjes së tij.

Për vitin shkollor në vazhdim në arsimin parauniversitar në qarkun e Dibrë janë në funksion 133 kopsh-te fëmijësh, nga të cilët 124 në fshat, me 4170 fëmijë, nga të cilat 1862 femra, 261 shkolla 9 vjeçare nga të cilat me cikël të plotë 9 vjeçar 113 dhe vetëm me cikël të ulët 148, me 28245 nxënës nga të cilët 13631 femra, në ciklin e ulët 12459 nxënës dhe në të lartë 15786, me 2606 nxënës të regjistruar në klasën e parë, nga të cilët femra 1166, të organizuar në 1317 klasa nga të cilat 405 klasa nga e para në të katërt, 591 klasa nga e pesta në të nëntë dhe 321 klasa të kombinuara .

Në 24 shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm me 203 klasat e tyre u regjistruan 6256 nxënës nga të cilët 3198 femra (në vit të dytë 2207 nxënës, në vit të tretë 2015 nxënës, në vit të katërt 1854 nxënës dhe në vit të pestë 180 nxënës) . Ndërsa në tre shkollat e arsimit të mesëm profesional u regjistruan 1620 nxënës, nga të cilët 1174 femra .

Për të mësuar e edukuar këtë numër nxënësish u vunë në dispozicion 2249 mësues e edukatore nga të cilët 817 (36.33%) pa arsim përkatës.

Në fund të semestrit të parë 149 fëmijë nuk frekuentuan kopshtin ndonëse ishin regjistruar, numri i frekuentuesve shkoi nga 4170 në 4021 nga të cilët 2340 në fshat.

Në arsimin 9 vjeçar u arrit kalueshmëria 85.6 %, ndërsa në fshat 84.7%, në arsimin e mesëm të përgjithshëm kalueshmëria kapi shifrën 58.1%, në atë pa ashkëputje nga puna 26%, në arsimin e mesëm profesional 63.8%, duke ardhur në atë që është e papëlqyeshme, por ndodh në kalueshmëri të lartë rreth 100% në fund të vitit mësimor.

Kam ndjekur me vemendje analizat e arsimit, raportet e diskutimet problemore, një pjesë prej të cilave jo të panjohura për mua dhe arrij në konkluzionin se problemet e arsimit në qarkun e Dibrës kanë filluar të rimerren.

Nuk është ideja këtu e një rimarrjeje në një shkallë më të lartë siç ndodh nga klasa në klasë, por një rimarrje thelbësore për të çuar përpara atë që është bërë mirë e për të ribërë atë që është thurur keq në fushën e arsimit.

Pozitiv është fakti që konstatohet se është rritur dhe vazhdon të rritet interesimi i komunitetit për t’u arsimuar.

Mesatarisht në Qarkun e Dibrës kanë vijuar mësimin në të gjitha ciklet e arsimit 9- vjeçar, të mesëm dhe në kopshte nga 45 – 50.000 nxënës në vit ose 18 – 21% e popullsisë, pa përfshirë këtu arsimin e lartë dhe numri i mësuesve ka lëvizur në shifrat nga 2300 – 2700 duke krijuar një mesatare një mësues për 16 deri në 18 nxënës.

Përmendëm këto shifra për të dalë te problemi. Është një popullsi e tërë që duhet mësuar e edukuar dhe dihet që edukimi fillon që në kopshte

PRODUKTET NGA ARSIMI DUHET TI PERGJIGJEN KERKESAVE TË SHOQERISE NJERËZORE DHE TE PARANDALOJNE TE GJITHA LLOJET E KRIZAVE

ku, sado të zbukurohet gjendja, problemet janë evidente që nga shtrirja e tyre gjeografike, numri i fëmijëve në grupe, disiplina shkencore e formale në mësimdhënie.

Në qarkun e Dibrës raportohen 4021 fëmijë frekuentues në kopshte, të cilët i edukojnë 227 edukatore. Fakti që 43.2% e edukatoreve janë në qytet dhe vetëm 14 prej tyre janë me arsim të lartë, apo fakti tjetër që në Mat e Bulqizë me tre bashki numri i fëmijëve në kopshte e qytetit është gati i barabartë me numrin e fëmijëve në 17 komunat e këtyre dy rrethëve, nuk ka nevojë për shumë komente për të nxjerrë problemet.

Pyetjet që rrinë varur e duan përgjigje janë : Sa është efektiviteti i këtyre kopshteve ?! Sa parapërgatiten fëmijët për në shkollë ?! Mos vallë në ndonjë rast kopshti është hapur apo mbajtur i hapur thjesht për një vend pune?! Sa e si drejtoritë e shkollave ushtrojnë kontroll rigoroz në kopshtet e fëmijëve për frekuentimin dhe cilësinë e mësimdhënies?! A ka raste kur drejtorët, veçanërisht dimrit, plotësojnë evidenca frekuentimi fallso ?! Sa rëndësi i kushtohet kontrollit në kopshte?! Sa është bashkëpunuar me organet e qeverisjes vendore për të siguruar kushtet e nevojshme në kopshtet në përgjithësi dhe ato me ushqim në veçanti?! Dhe mbi të gjitha çdo të bëhet në ato fshatra ku nuk ka kopshte?! Sa ndikim negativ ka fakri që mijëra fëmijë ulen në bankot e shkollës pa kaluar më parë në tavolinat e vogla të kopshteve ?

Vazhdojmë më tej me arsimin. Rezultatet e semestrit të parë jo se janë të kënaqshme.

Duke besuar në rritjen reale të kalueshmërisë në arsimin 9 – vjeçar deri në fund të vitit, çdo vëzhgues, kur shikon këto shifra të kalueshmërisë në arsimin e mesëm, ka të drejtë të paktën të mendojë se ai po kthehet figurativisht “në një kopësht për të rinjtë”, një vend ku prindi sjell fëmijnë që të mos rrijë rrugëve, aq më keq kur kjo përqindje në fund të vitit “katapultohet”.

Në praktikën e përditëshme të mësimdhënies takohen fenomene që në disa raste përbëjnë dhe shkelje ligjore si : shkelje të Udhëzimit të MASH për normat mësimore ; ka mjaft mësues pa arsim përkatës, mungojnë nxënës, kryesisht në arsimin e mesëm e nuk vihen mungesa ; probleme ka arsimi i mesëm i përgjithshëm me kohë të shkurtuar, transporti i mësuesve dhe nxënësve, furnizimi i shkollave me energji, kur në mjaft prej tyre ka mësim pasdite, apo mbetet pa lidhur interneti, pajisja me bazë materiale, një pjesë e këtyre problemeve është e varur

pjesërisht apo plotësisht nga puna e mësuesve.

Problemët sjellin nevojën që shkolla, në kushtet aktuale, duhet të ketë një organizim dhe drejtim më operativ dhe shkencor.

Që nxënësi të mësojë në shkollë së pari atij i duhen krijuar kushtet personale e kolektive për mësim. Ndërsa për kushtet personale është përgjegjës prindi, për kolektivet jemi të gjithë, pasi një fëmijë nuk do ta ketë mendjen në mësim nëse është në një klasë pa xhama, nuk ka lëndë ngrohëse apo dhe më keq kur në shumë shkolla në shkallë qarku zhvillohet mësim në mjedise me qera.

Në plotësimin e këtyre kushteve, rol të dorës së parë luan bashkëpunimi mes drejtorive arsimore e atyre të shkollave me organet e qeverisjes vendore, i cili diku ka qenë i sukseshëm, diku i vakët e diku dhe ka munguar .

Krijimi i kushteve në shkolla natyrisht që kërkon dhe dorën e shtetit nëpërmjet investimeve.

Hedhim në letër shifrat e investimeve në arsim tre vitet e fundit, 2006, 2007, 2008.

Në vitin 2006 në Bulqizë u investuan në arsim 18. 805.000 lekë, në Mat 32.791.000 lekë dhe në Diber 60.906.000 lekë, gjithsej në qark 112. 502.000 lekë.

Në vitin 2007 në Bulqizë nuk u realizua asnjë investim, në Mat 34.802.000 lekë dhe në Diber 54.270.000 lekë, gjithsej në qark 89.525.000 lekë.

Në vitin 2008 në Bulqizë u realizuan 23.402.000 lekë investime , në Mat 93.050.000 lekë dhe në Diber 172.847.000 lekë, gjithsej në qark 289.299.000 lekë investime.

Ajo që kërkon përmirësim në këtë drejtim dhe varet nga institucionet qëndrore në nivel vendor të fushës së arsimit, mendojmë se është studimi më i mirë për shkollën ku do të investohet, pasi jo në pak raste janë ndërtuar objekte te reja me vlera të mëdha monetare në fshatra, ku numri i popullsisë është i vogël, ndërsa janë lënë pas dore zona me popullsi të konsiderueshme. Aq më keq kur konstatohen dhe raste që në të njëjtën shkollë është investuar dy apo tre herë brenda pak vitesh, gjë që vë në pikëpyetje të plotë cilësinë e investimit për të mos thënë më tepër.

Pr raste kur investimi nuk e justifikon qëllimin.

Me keqardhje vihet re se në ndonjë organ të Qeverisjes Vendore ka zell për të ndërtuar një rrugë, një ujësjellës apo diçka tjetër që i shërben komunitetit në një shkallë më të lartë se sa të merret me probleme të shkollës, duke e lënë atë qoftë dhe pa një fshesë.

Në këtë drejtim gjykojmë se është domosdoshmëri që në çdo skaj të Qarkut te merret parasysh mendimi i drejtuesve të arsimit për ndarjen e bllok-grantit dhe granti i ndarë të shkojë atje ku është miratuar e jo të tjetërsohet, të respektohet kjo ndarje, të ketë transparencë.

Drejtori i shkollës, stafet pedagogjike, bordet e prindërve, qeveritë e nxënësve duhet të jenë shumë kërkuar dhe operativë në këtë

drejtim.

Një problem i kthyer në fenomen shumë shqetësues me të cilin është ballafaquar arsimi në vite, është braktisja e dukshme dhe e padukshme e shkollës nga nxënësit. Në vitet 1997 – 2007 numri i nxënësve braktisës sipas viteve në shkallë qarku është : 1466- 2042- 1948- 1370- 1248- 752- 697- 711- 598- 436, nga 3.6% në 1.52%.

Është fakt që fenomeni i braktisjes ka ardhur në ulje për çdo vit duke qenë më i pakët në Bulqizë e Mat dhe më i theksuar në Diber.

Por këtu mendoj se duhet bërë shumë kujdes me braktisjen e fshehtë, që është pasojë e kalimit të nxënësve nga klasa në klasë, pa njohuritë minimale të domosdoshme, fenomen i cili mbart edhe aplikimin e formave dhe mjeteve abuzive, apo fshehja e braktisjes thjesht për arsye statistikore.

Janë probleme këto, që po e dëmtojnë rëndë arsimin dhe për të cilat duhet forcuar kontrolli dhe vendosur sanksione ligjore, gjë për të cilën në gjithë periudhën e demokracisë organet e qeverisjes vendore nuk kanë zbatuar për asnjë rast vendimet e drejtorive të shkollave për vendosje gjobash.

Braktiset shkolla. Krijohet mendimi dhe perceptimi i gabuar se një pjesë fëmijësh nuk duan të arsimohen, nuk e kanë qejf shkollën, dijen . Por kjo nuk është absolutisht e vërtetë . Nuk janë fëmijët që nuk e duan shkollën, por një sërë fenomeneesh e faktorësh të tjerë që e sjellin këtë dukuri të pakëndshme.

Shkaqet e fenomeneve negative në arsim i gjykojmë të shumta, ndër të cilat mund të përmenden : niveli i ulët ekonomik i familjeve, zënia e fëmijëve me punë, kryesisht me bagëti apo bimë medicinale në fshat dhe me tregti ambulante në qytet, në ndonjë rast dhe ikja e tyre në emigracion, niveli i ulët arsimor i kuadrit mësimdhënës në disa zona, mungesa e kushteve të përshtatshme në shkolla, puna e pakët edukative deri te mos orientimi, në raste të veçanta, i vetë mësuesve se çfarë duhet të bëjnë e të trajtojnë me nxënësit, zbehja e lidhjes së shkollës me komunitetin, me prindërit, fallsiteti i kësaj lidhjeje, në ndonjë rast lidhje kjo e krijuar mbi bazë interesash, largësia e fshatrave nga shkolla, mungesa dhe rëndësia në dimër e infrastrukturës për transportin e fëmijëve në zonat rurale, moszbatimi i ligjit për detyrimin shkollor nga organet e qeverisjes vendore, mosvjelja e gjobave nga ana e tyre, rënia e interesit për shkollën dhe koncepti “Ç’na duhet shkolla”, papunësia e të shkolluarve, paradoksi që në disa raste i shkolluari është në rrugë apo kioskë, ndërsa i pashkolluari ka kapur administratën shtetërore lokale, mbartja e kontigjentit përsëritës nga viti në vit, ndikimi i shembullit negativ, në ndonjë rast dhe personaliteti pa personalitet i ndonjë mësuesi .

Pa u zgjatur do të thoja se një mësues pa personalitet apo me moral të cunguar i sjell edukimit një dëm të pallogaritshëm.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Këshilli Bashkiak i Kamzës ka emëruar disa nga rrugët e qytetit me emrat e komunave, qyteteve, vendeve historike të Qarkut të Dibrës

“Dibra vjen në Kamëz”

Bashkia Kamëz: 34 rrugë emërtohen me emrat nga qarku i Dibrës

Këshilli Bashkiak i Kamzës ka emëruar 34 rrugë në me emra vendesh e ngjarjesh që kanë të bëjnë me Qarkun e Dibër. Këtë e konfirmojnë kryetari i bashkisë së Kamzës, z. Xhelal Mziu, në një letër drejtuar Prefektit të Dibrës, z. Xhafer Seiti. “Letra që po ju dërgoj ka të bëjë me një ngjarje të rëndësishme në jetën e komunitetit të qytetit të Kamzës, dhe mendoj se kontribuon edhe më shumë në marrëdhëniet e bashkëpunimit midis institucioneve tona”, shkruan në fillim të letrës kryetari i bashkisë. “Kamza, një qytet i rikrijuar kryesisht pas viteve 90-të, me sip. 21.7 km² e popullsi 90.000 banorë, rrjedhojë e migrimit të popullsisë së ardhur nga i gjithë vendi, ka një pozicion të rëndësishëm gjeografik në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme që lidhin Veriun e Jugun e Shqipërisë me Tiranën, në Trekëndëshin Tiranë-Rinas-Durrës. Si rezultat i kësaj jo vetëm është populluar me një shpejtësi marramendëse, por janë kryer edhe investime të gjithanshme, ndërtime private e publike, rrugë të reja, objekte socialkulturore, stadiumi i qytetit, etj, pra është transformuar e gjithë infrastruktura e qytetit, gjë që e kanë ndryshuar rrënjësisht Kamzën. Në ritmet e zhvillimeve bashkëkohore e vendosjes së

kontureve të një qyteti modern, së shpejti hapet Qendra e Pritjes, Informacionit e Shërbimeve (one stop shop), i pari në llojin e tij dhe më i madhi në vend, një kompleks i vërtetë shërbimesh. Në këtë qytet krejtësisht të ri, për lehtësimin e shërbimeve dhe administrimin sa më mirë të tij, hartuam e zbatuam projektin e adresave dhe kodifikimin e banesave e të gjitha objekteve në territorin e Bashkisë sonë”, shkruan në letër drejtuar Prefektit, z. Mziu. “Në këtë logjikë me vendim të Këshillit Bashkiak të Kamzës, disa nga rrugët e qytetit tonë kanë marrë emrat e

komunave, qyteteve etj., që përfshihen në prefekturën tuaj, shkruan kryetari i Bashkisë së Kamzës, duke renditur më poshte emrat e rrugëve: **Rruga Peshkopi, rruga Bulqizë, rruga Burrel, rruga Klos, rruga Fushë-Bulqizë, rruga Gjoric, rruga Kala e Dodës, rruga Kastriot, rruga Komsj, rruga Lis, rruga Lurë, rruga Luzni, rruga Macukull, rruga Maqellarë, rruga Martanesh, rruga Melan, rruga Ostren, rruga Tomin, rruga Rukaj, rruga Selishtë, rruga Shupenzë, rruga Sllovë, rruga Suç, rruga Rukaj, rruga Xibër, rruga Zerqan, rruga Zall-Reç, Rruga Zall-Dardhë, rruga**

Kuvendi i Dibrës, rruga Kongresi i Dibrës, rruga Dibra, rruga Mat, rruga Korab, rruga Drini”.

“E konsideroj veprimin tuaj mbi të gjitha si shenjë respekti për banorët e këtyre trevave, - shkruan mes të tjerash Prefekti i Dibrës, z. Xhafer Seiti, - duke shprehur vlerësimin tuaj mbi të gjitha si shenjë respekti për banorët e këtyre trevave.

Veprimi i Këshillit Bashkiak të Kamzës është pritur mirë edhe nga banorët e kësaj bashkie, duke e konsideruar këtë veprim si një lidhje të fortë me vendin e origjinës.

Korresp. “Rruga e Arbërit”



vendimi

U konstituua Këshilli i Komunës së Dibrës së Madhe

Pas zgjedhjeve vendore më 22 mars, u mbajt mbledhja konstituive e Këshillit të Komunës.Në këtë mbledhje ishin të pranishëm 6 këshilltarët e BDI-së, 3 të DR-së dhe nga 1 të PDSH-së PPD-së, VMRO-së, LSDM-së, PEI dhe PPER.

Ilir Cami, kryetar i Këshillit Zgjedhor Komunal para të pranishëmve raportoi për rezultatet e zgjedhjeve vendore në komunën e Dibrës së Madhe.

Me shumicë votash kryetar i Këshillit Komunal u rizgjodh Inxh.i dipl.Nizamedin Papraniku,i cili duke u falenderuar për këtë zgjedhje, theksoi se: “Më shumë se në mandatin e kaluar do të angazhohem për bashkëpunim me këshilltarët e partive pjesëmarrëse në këshill, për të marrë vendime të pjekura dhe për t'i vënë interesat e përbashkëta mbi ato partiake dhe në të mirë të qytetit”.

Mr. Ruzhdi Lata-myftiu i Dibrës ë Madhe në fjalën e tij përshëndetëse,shtoi se,“Dibra historikisht ka patur kuvendin e burrave që pasqyronte urtësinë dhe trimërinë dibrane. Juve këshilltarë populli ua dha votën, ky besim wshtw nder pwr ju, dhe këtë besim tani duhet ta justifikoni me angazhimin, punën dhe rezultate në kthimin e vlerave ekonomike,kulturore dhe historike të Dibrës së Madhe”.

Argëtim Fida-kryetar i komunës së Dibrës së Madhe,deklaroi se:“Sëbashku me administratën komunale, me intelektualët do të jemi pranë Këshillit të Komunës në realizimin e objektivave tona.I ftoj këshilltarët e partive tjera për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar aktivitetet në drejtim të prosperitetit të Dibrës së Madhe dhe dibranëve”.

R. T.

PËRKUJTOHET PROF.AKADEMIK BEDRI DEDJA

Atë që i takonte ta bënte Akademia e Shkencave të Shqipërisë e bëri Universiteti Ufo i cili nën përkujdesjen e katedrës së psikologjisë së këtij universiteti dhe drejt për drejt të Prof.Dr Nuri Abdiut më datën 9 prill ora 18 u kujtua 5 vjetori i vdekjes së Prof.Akademik Bedri Dedja.Salla ishte mbushur plot me njerëz të moshave të ndryshme, familjarë, pedagogë e psikologë, studiues e studentë.Miq dhe shokë të Akademik Bedri Dedes bren-da dhe jashtë trojeve të vendit tonë.Ishte rektori i këtij Universiteti, ai që hapi i pari këtë seminar përkujtimor për t'ia dhënë pastaj fjalën Prof.Dr.Nuri Abdiut i cili foli për jetën dhe veprën e Prof. Akademik Bedri Dedes.Një kumtesë mbajti dhe Prof.Akademik Pajazit Nushi i cili kishte ardhur posaçërisht për këtë përvjetor nga Prishtina. Vlerësime të shumta u thanë edhe nga auditori për Prof.Akademik Bedri Dedja si shkrimtarë e studiues i madh,

mendimtar e dijetar shumëvlerësh,personalitet i shquar i Shqipërisë,prijetar për pavarsinë e shkencës, themelues i letërsisë për fëmijëetj.Por pak dhe prerë tha Naim Plaku: -Kam patur rastin të njihem nga afër me Prof.Akademik Bedri Dedja. Atëherë vinte në Dibër për kontroll nga Ministria e Arsimit e unë punoja mësues në shkollën e Sllovës.Një natë qëndroi me ne bashkë në Vleshë ku kemi fjetur në të njëjtën dhomë. Kur u largua nga vlerësimet që bëri, ne si shkollë na kishte nxjerrë në vend të parë.Ai ishte dhe mbeti një mik i përhershëm i të gjithë dibranëve.Nuk ishte vetëm shkolla e Sllovës që pa vetë.Bedri Dedja në Dibër ka shkelur nëpër shumë rrugë e shigje. Në fund vajza e tij Edlira Dedja (Bytyçi) bëri promovimin e librit të fundit të botuar pas vdekjes, si një testament të tij"Presidenti i planetit të kuq" një roman i ilustruar për fëmijë.

Tadiqi vjen në Kosovë, Sejdiu s’guxon në Mitrovicë

(Vijon nga faqja 4)


I nxorrën me hanxhar syçkat e djaloshit tre vjeçar dhe ashtu të përgjakura e të ngrohta e detyruan me forcë që t’i gëlltisë. Këtë ia bënë serbët nënës së urtë e të ndershme shqiptare, si edhe mijëra nënave tjera, të cilat gjithnjë patën në zemër nderin, bujarinë, fisnikërinë, e të cilat asnjëherë nuk dijtën as të fyejnë e as të ngucin kend”. Kjo është vetëm një grimcë jete që pasqyron imazhin serb në Kosovë , një grimcë nga gjithë ato vuajtje shkekullore që i pësuan shqiptarët, edhe pse jetonin në shtëpitë dhe trojet e veta.

Hordhitë ushtarake, policore dhe paramilitare gjakatare serbe në luftën e fundit në vitin 1999 dogjën qindra mijëra shtëpi,vranë e masakruan dhjetëra mijëra njerëz të pafajshëm, duke prerë koka fëmijësh me hanxharë, duke vlarë pleq dhe duke përdhunuar mijëra vajza shqiptare. Ata me dhunë të paparë në rruzullin tokësor, duke djegur, shkatëruar dhe grabitur fshatra dhe qytete të tëra, detyruan të shpërngulen afër 1 milion shqiptarë nga Kosova, mw shumë se 2000 persona konsiderohen të zhdukur, kurse 600 tw tjerë ndodhen nw morg dhe presin të indentifikohen.

LIBRI QË DUHET PËRKTHYER DHE SHPËRNDARË NËPËR BOTË

Libri “Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë” i autores Luljeta Selimi, është një argument i fuqishëm për Kosovën. Secili që do ta lexonte këtë libër, do të rrënoqet kur do të kuptonte se çfarë krimesh kanë bërë serbët edhe ndaj femrave shqiptare në Kosovë, dhe me siguri do të kuptonin e bindeshin që pa mëdyshje të jenë në anën e shtetit të ri të Kosovës,në anën e të vërtetës.

Ja disa grimca nga ky libër. “ Ma pushkatu-



faksimile e hartës së Enciklopedisë Ruse që tregon kufijtë realë të Serbisë në vitin 1817

an nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin tim e masakruan për së gjalli me cigare”. Një nga mjeket deklaroi se,“Vajzës së dhunuar i ishte shqyer mitra dhe se në organet gjenitale i kishn futur rërë, këmbët i kishte të

gërvishtura dhe mes dy gjinjëve me majën e thikës kishte të vizatuar kryqin serb”. Ose rrëfimet e tjera,” Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vlarë, e mua më çnderonin vetëm disa metra larg tij”, Pasi ma

vranë djaln, mua më çnderuan disa ditë me radhë”, “Djalit dy vjeçar ia prenë veshin dhe tre gishtërinj, e pastaj më dhunuan”, “Më dhunuan para syve të nënës”, “Më dunuan e ma prenë gjirin”, “Cigaren e ndezur e fiki në gjinj të mi”, “Me thikë shkruan fjalë mbi trupin tim, “Më detyronin t’i shiqoja femrat që po i dhunonin me radhë”, “Pasi më dhunuan, m’i hogën thonjtë me dana”, “Motrën e mbytën me kundak të pushkës”, “14- vjeçarja u dhunua në borë”, “Pasi e dhunuan 13-vjeçaren e hudhën në pus”, “Më çnderuan para syve të babait dhe nënës”, “Në muajin e tetë të shtatzanisë më përdhunoi para vjehrës dhe burrit, e pastaj më goditi në gjoks e në bark dhe linda fëminë e vdekur”, “ Më dhunuan dhe në krah ma vizatuan kryqin serb”, “Pasi i çnderuan tri vajza, ua prenë organet gjenitale”

Ky libër është dashur menjëherë të përkthehet në gjuhët e huaja dhe tu adresohet të gjithë ambasadorëve në Këshillin e Sigurimi të OKB-së, Unionin Evropian, Këshillin e Evropës, Grupin e Kontaktit dhe tërë burshtetasit evropianë e botërorë, që duke e lexuar këtë libër ta kuptojnë më mirë e një herë e përgjithmonë, se çfarë krimesh shtazarake kanë bërë serbët ndaj kosovarëve të pafajshëm dhe sidomos ndaj vajzave dhe grave shqiptare kosovare.

Me qëllim të sensibilizimit dhe përkthimit të këtij libri dy viteve të fundit ne ju kemi dërguar Letër të hapur Qeverisë së Shqipërisë, Qeverisë së Kosovës, Lidhjes Shqiptare në Botë, Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan dhe biznesmenëve shqiptarë, por për fat të keq pa asfarë suksesi.

Kushdo që do ta përkthejë, botojë dhe shpërndajë nëpër botë këtë libër, do ta nderojë veten dhe do të bëjë gjënë më të çmuar për Kosovën dhe çështjen shqiptare.

Dibra e Madhe në krizën ekonomike globale

Pyetur se a e ka prekur kriza ekonomike globale Dibrën e Madhe, kryetari Argëtim Fida, thotë se: "Dibra e Madhe është komunë me një numër të konsiderueshëm të bashkëqytetarëve në diasporë në SHBA dhe Evropë. Jam i bindur se kriza ekonomike globale do të ketë implikime edhe në Dibrë të Madhe drejtpërdrejt apo indirekt. Kjo për shkak se atje ka reduktim të vendeve të punës dhe standardi jetësor në Evropë nuk është si para disa viteve. Ata që kanë edhe familjet e tyre në Itali apo gjetiu, dhe qw do tw mbeten vetëm me një rrogë, familjet e tyre do t'i kthejnë në vendlindje".

Fenomen shqetësues, shton ai, është deportimi në muajt e fundit i disa dibranëve nga SHBA-të, të cilët muk e kanw tw siguruar dokumentacionin e duhur për të jetuar dhe punuar në SHBA. Nëse ky fenomen do të vazhdojë, do të rritet numri i dibranëve që do të kthehen nga SHBA-të. Kjo do të shkaktojë problem social për komunën".

Në pyetjen a ka ndonjë strategji për përballimin e kësaj krize, Fida përgjigjet se, "në programin tonë elektoral patëm parashikuar përgatitjen

e komunës për hapjen e vendeve të reja të punës në lëmitë e prodhimit, pikërisht për personat me kualifikim të mesëm ose pa kualifikim. Ne mendojmë t'i rristrukojmë të gjitha potencialet ekonomike, për të krijuar hapësirë për personat që janë këtu, por edhe për ata që eventualisht do të kthehen. Atyre që kanë fituar përvojë dhe kanë kapital, do tu krijojmë mundësi të fillojnë bizneset e tyre private, ku do të hapen edhe vende të reja pune. Komuna e jonë bie në kategorinë e komunave të pazhvilluara. Liberalizimi i vizave pa ndërtimin e Rrugës së Arbërit ende nuk i ka dhënë rezultatet e pritura në ndërtimin e kapaciteteve tregtare, hotelierike dhe kapaciteteve të industrisë së vogël. Stafi i komunës është duke u përgatitur të ballafaqohet me sfidat e krizës ekonomike globale".

Pyetjes si do të veprohet konkretisht, kryetari Fida, i përgjigjet: "Rritja e interesit për dy përqind te bankat tona është element i dëmshëm, sepse të gjithë mendojnë të hapin biznese duke shfrytëzuar edhe linjat kreditore. Ne si komunë nuk mund të dalim mbi politikat globale shtetërore dhe vizionet tona duhet të inkorporohen në kuadër të problemeve globale. Bi-

Argëtim Fida: Jam optimist se Dibra e Madhe do ta përballojë këtë krizë ekonomike globale

zneshi në Dibrë të Madhe nuk është involvuar shumë në kredi. Në të kaluarën dibranët nuk kishin shumë mundësi të marrin kredi. Tani kur ndryshoi situata mosngarkimi i ekonomisë me kredi është element lehtësues për ta përballuar më lehtë këtë periudhë. Do të bazohemi kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe blektorisë, ku grantet janë të garantuara nga fondet evropiane. Duhet të kujdesemi në kalimet kufitare të mos ketë keqpërdorime, që plasmani i prodhimeve bujqësore e blektorale të jetë i garantuar. Kombinati i gjipsit KNAUF e ka të stabilizuar tregun, nuk rrezikon zvogëlimin e të punësuarve, por mund ta vonojë hapjen e vendeve të reja të punës.

Jam optimist se Dibra e Madhe do ta përballojë këtë krizë ekonomike globale", tha në fund kryetari Argëtim Fida. /R.TORTE



Dibrë e Madhe - Bujar Osmani vendosi gurthemelin e ambulancës së re Mbrojtje shëndetësore për të gjithë

"Ne punojmë të sigurojmë mbrojtje shëndetësore cilësore për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike dhe fetare. Ky gurthemel i ambulancës në fshatin tuaj është bazë për të ardhmen tuaj dhe të fëmijëve tuaj. Kjo ambulancë do të jetë bashkëkohore e pajisur me instrumente dhe personel përkatës, për të qenë gjithnjë pranë banorëve të këtushëm. Këtë gurthemel mund ta vendosim edhe para zgjedhjeve, por nuk e bëmë për të mos u kup-tuar si fushatë parazgjedhore. Ne e mbajmë fjalën e dhënë dhe kjo është mënyra më e mirë për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë", tha Bujar Osmani, ministër i shëndetësisë së Maqedonisë më 17 prill 2009, me rastin e vendosjes së gurthemelit të ambulancës në fshatin Kosovrast i Epërm në Komunën e Dibrës së Madhe.



Bujar Osmani duke vendosur gurthemelin

Ylber Kokale, drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Dibrë të Madhe, duke përshëndetur të pranishmit, shtoi se: "Kjo ambulancë do të jetë në shërbim të kërkesave për mbrojtjen e shëndetit në këtë fshat. Angazhimi i ministrit Osmani bëri që kjo ëndër e kahmotshme të bëhet realitet".

Argëtim Fida, kryetar i komunës Dibrë e Madhe, falenderoi për zgjedhjet fer e demokratike dhe për mbështetjen që banorët e këtij fshati i dhanë BDI-së në zgjedhjet e

marsit, duke theksuar se edhe në të ardhmen nuk do të mungojë kujdesi dhe ndihma për përparimin e këtij fshati.

Kryetari i bashkësisë lokale falenderoi për ndërtimin e kësaj ambulance, duke theksuar se 900 banorët e fshatit deritani kanë jetuar në kushte teper të vështira të mbrojtjes shëndetësore.

Në vendosjen e këtij gurthemeli morrën pjesë Bujar Osmani, ministër i shëndetësisë së Maqedonisë, Argëtim Fida, kryetar i komunës Dibrë e madhe, Ramiz Merko, kryetar i komunës Strugë, Ylber Kokasle, drejtor i Shtëpisë së Shëndetit, Baki Alili drejtor i Spitalit të Përgjithshëm, Mr. Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës së Madhe dhe të ftuar tjerë.

Rexhep TORTE

Dibrë e Madhe - Takim i mamive të Maqedonisë Shtatzani dhe foshnje të shëndosha

Në organizim të Seksionit të mamive të Maqedonisë më 28 mars, në Dibrë të Madhe u mbajt Takimi i dhjetë i mamive të Maqedonisë, ku përveç afër 300 mamive morën pjesë Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe dhe Baki Alili, drejtor Spitalit të Përgjithshëm dhe Ylber Kokale, drejtor Shtëpisë së Shëndetit.

Besa Çutra, në emër të Spitalit të përgjithshëm, u shpreh se: "Dibra është simbol i bashkëjetesës dhe i respektimit të ndërsjellë pa marrë parasysh përkatësinë etnike e fetare".

Argëtim Fida, duke e përshëndetur këtë takim, tha se, "Unë me profesion jam gjinekolog dhe e kuptoj më së miri ndihmën dhe angazhimin tuaj për të ardhur në jetë foshnjat, sepse ju prindërve ua komunikoni lajmet më të bukura për lindjen e foshnjeve të tyre. Dëshiroj ta shijoni sa më mirë bujarinë dhe mikpritjen dibrane. Jemi përpjekur që në qytetin tonë të krijojmë kushte sipas standardeve. Me udhëheqësinë e spitalit dhe me Ministrinë e Shëndetësisë edhe në të ardhmen do t'i përmirësojmë standardet e gjinekologjisë dhe akusherisë".

Tanja Trajkovska, kryetare e Seksionit të mamive të Maqedonisë, theksoi se: "Seksioni ynë është anëtarësuar në Konfederatën ndërkombëtare të mamive. Përpjekjet tona janë në drejtim të mjekësisë parësore, edukim-

it dhe preventivës që foshnjat të lindin të shëndosha".

Ruzhica Stanojkovska-Kumanovë, foli për rolin e mamisë gjinekologjike-akusherike në diagnostikën preventive në evaluacionin perinatologjik të bakterieve vaginale, përdorimin e medikamenteve mbrojtëse për evitimin e lindjeve të partakohshme. Millka Andonova-Shkup, foli për mënyrat e reja të trajtimit të lëkurës të foshnjat e porsanindura.

Në vazhdim mamitë specialiste nga Shkupi dhe Çairi i Shkupit shtjelluan temat krahasuese të aplikuara nëpërmjet punëtorive të Projektit për trajtimin e lehonave dhe të lindjeve të foshnjeve në Angli dhe Maqedoni, mbi bazën e edukimit, analizave dhe tepapive para dhe pas lindjes dhe shkëmbimin e përvojave për të patur shtazani të shëndoshë dhe foshnje të shëndosha.

Zejnep Shemshi, mami nga Dibra, prezentoj përvojën e mamive në Dibrë në procesin e shtatzanisë dhe të lindjes së foshnjeve.

Në këtë takim u ra dakord që në Maqedoni të vazhdojnë aktivitetet për të punuar sipas standardeve dhe kompetencave të protokollit gjinekologjik-akusherik dhe të botohet një udhëzues për zbatimin e drejtë të këtij protokollit shëndetësor.

Rexhep TORTE



Një vështrim i përgjithshëm mbi Bulqizën, shkruar me dashuri dhe pasion nga Shpëtim Cami... Historia, traditat, kultura, etnografia dhe jeta e përditshme e një komuniteti që çdo ditë kërkon ta jetojë

vendlindja

Nga: SHPËTIM CAMI

Rrethi i Bulqizës shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe bën pjesë në qarkun e Dibrës. Deri në vitin 1992 Bulqiza ka qenë pjesë e rrethit të Dibrës, ndërsa që nga ai vit është rreth me vete.

Rrethi ka tetë njësi administrative: Bashkinë e Bulqizës dhe shtatë komuna, si: Fushë Bulqizë, Martanesh, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren, Trebisht.

Rrethi përbëhet nga 62 fshatra. Nga pikëpamja krahinore ndahet në tri pjesë: Bulqiza, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël dhe Golloborda .

Bulqiza dhe fshatrat e saj dëshmojnë si vendbanime të hershme me gjetjet arkeologjike në fshatin Krahkë të komunës Zerqan apo në Shupenzë. Ndërkaq fusha e Gjoricës ka hyrë në histori që nga koha e Skënderbeut. Kjo fushë si dhe luginat e Fushë Bulqizës dhe ajo e Vajkalit ishin rruga e asaj kohe nga hyrja e dilnin ushtritë pushtuese.

Në të dalë të Bulqizës, në anën e djathtë të rrugës ndodhet një lapidar. Këtu më 29 qershor të vitit 1444 Gjergj Kastrioti Skënderbeu ka zhvilluar kundër osmanëve betejën e njohur të Torviollit. Këtë ngjarje historike e pasqyron edhe Fan Noli në librin e tij “Histori e Skënderbeut”. Ai përshkruan betejën në të cilën u thyë keqas për herë të parë ushtria turke, që komandohej nga Ali Pasha.

Në fushën e Vajkalit janë zhvilluar edhe dy beteja të tjera si ajo kundër Mehmet Pashës dhe kundër Ballaban Pashës.

Sot është e vështirë që të zgjosh kureshtjen për treva që ndodhen jashtë qendrave të mëdha të banimit ose jashtë kryeqytetit, për shkak të globalizimit dhe migrimit masiv të brendshëm, por gjetja e mundësive për njohje dhe prezantimin e pasurive të të gjitha fushave, si: historike, kulturore, fetare, minerale, turistike, bujqësore, është detyrë e secilit prej nesh.

Rrethi i Bulqizës ka një natyrë të mrekullueshme me gjelbërim, pyje, kullota, pasuri ujore, liqene në pranverë dhe e mbuluar me dëborë në dimër.

Në pjesën lindore laget nga lumi Drini i Zi që shërben edhe si vijë kufitare, ku shtrihen fshatrat Gjoricë dhe Viçisht. Dy lumenj të vegjël si Zalli i Strikçanit dhe ai i Bulqizës e përshkojnë si damarë gjaku mes për mes për t’u derdhur pastaj në lumin Drin pranë Urës së Topojanit.

Pjesa më pjellore e këtij rrethi është Fusha e Gjoricës, e shtrirë buzë

“Pasuria me tre emra”



Lapidari i Torviollit

lumit Drin me një bukuri mahnitëse. Gjorica është qendra e komunës me të njëjtin emër, ku është ngritur i pari batalion partizan i rrethit Dibër. Ky fshat dhe fusha e tij kanë mbetur në histori edhe për luftën e forcave dibrane të udhëhequra nga Nëntë Malet e Dibrës, kundër ushtrive turke të drejtuara nga Hajredin Pasha. Këtë betejë dibranët e kanë gdhendur dhe në këngën popullore. Sipas burimeve historike, është një nga betejat më të ashpra dhe më të përgjakshme të zhvilluara në historinë tonë. Mbetën të vrrarë mbi dhjetë mijë turq e dibranë. Nga ajo kohë vendi ku është zhvilluar beteja quhet Fusha e Thatë. Legjenda dhe e vërteta pleksen e vështirë të ndahen. Siç duket, edhe tani vendi ose fusha ku është zhvilluar beteja në dimër e verë është e thatë dhe pa gjelbërim. Shikojeni! Nga të dyja anët ka gjelbërim, ndërsa në pjesën ku është zhvilluar beteja jo, sepse, sipas gojëdhënës, ajo pjesë toke është e tejngopur me gjak dhe është tharë dhe e ka humbur pjellorinë.

Mbi fshatin Gjoricë, në kodrën e Çerenecit, të tërheq vëmendjen një lapidar, i një stili të veçantë. Është ngritur në kujtim të komandantit të batalionit italian “Antonio Gramshi” Tercilio Kardinali, i cili luftoi krahas forcave partizane kundër push-



Fusha e Gjoricës

tuesve gjermanë.

Duke ecur buzë Drinit të Zi arrijmë në fshatin Viçisht. Edhe ky një fshat me histori luftërash. Sipas librit të autorit Gazmend Shpuza: “Kryengritjet fshatare në Shqipëri në vitet 1914 – 1915” thuhet se pas traktatit të 26 prillit 1915 të katër Fuqive të Mëdha, filluan provokacionet ndaj Shqipërisë edhe nga serbët, pikërisht në këtë fshat për një copëtim të mëtejshëm të Shqipërisë. Njërit prej këtyre provokacioneve serbe iu përgjigjen edhe forcat dibrane të komanduara nga Fet Cami në maj të vitit 1915. Beteja u zhvillua në përronin e fshatit Tërbaç, fshat ngjitur me Viçishtin, duke i detyruar serbët të tërhiqeshin. Pas një muaji serbët sulmojnë përsëri, me një numër më të madh forcash, por menjëherë u përballën me forcat shqiptare të komanduara nga Dan Cami. Për shkak të këtyre dy qëndresave shtëpitë e fisit Cami në Viçisht dhe Tërbaç u dogjën dhe u shkatërruan masivisht.

Pas largimit të serbëve më 1916, këto territore u pushtuan nga bullgarët. Ishin përsëri banorët e fisit Cami ata që u përballën me pushtuesin e ri. Për shkak të rezistencës pushtuesit vranë Ramiz Camin, Fet



Lapidari kushtuar dëshmorëve të fshatit Viçisht

Camin dhe arrestuan Beqir Camin, të cilin e pushkatojnë më vonë në Sofje. Kjo jetë e vështirë në kufi dhe në kontakt të përhershëm me luftën e ka mbushur këtë vend me histori e përmendore.

Në lagjen Miresh të fshatit Tërbaç ndodhet një lapidar, i cili iu kushtohet dëshmorëve Ejup Cami, Musa Cami, Sefer Cami dhe Mexhit Lezi, të cilët pikërisht në këtë vend janë dënuar me pushkatim nga pushtuesit italianë në prill të vitit 1941.

Ngjitemi më lart buzë kufirit shtetëror, ku vijnë fshatrat e krahinës së Gollobordës, e përbërë nga komunat Ostren dhe Tërabisht.

Fshati Trebisht, i vendosur në një shpat, është një vend i organizuar dhe me jetë aktive .Këtu tregojnë se më 1913, në kohën që po përcaktoheshin kufijtë nga komisioni ndërkombëtar, ishin ndeshur me një plakë që u kish-te folur shqip duke iu thënë se ky është një fshat shqiptar.



Pamje nga Bulqiza dhe Miniera e saj



Pamje e Teqes, Fushë Bulqize



Ura e Topojanit



Pamje nga fshati Ostren i Madh

ka më zhurmën dhe shkëlqimin e dikurshëm. Ngjitemi në Zonën D dhe përqark duken rrënojat e godinave të dikurshme si dhe kapononet e kampit të të dënuarve politikë. Miniera tani administrohet nga një kompani private italiane "DARFO", e cila ka të punësua rreth 600 punëtorë. Pjesa jo rentabël e saj administrohet Kompania Shtetërore e Albkomit. Sot është pak e vështirë të mendosh se si mund të rivihet në lëvizje kjo industri, po drejtuesit e këtij rrethi përpiqen të gjejnë hapësira. Jo pak intelektualë të kësaj zone, që banojnë e punojnë në Tiranë, interesohen që të mbështesin përpjekjet e drejtuesve të minierës apo të ndonjë institucioni tjetër, me qëllim ngjalljen e shpresës për një jetë më të mirë të këtyre banorëve...

Nisemi përsëri drejt Bulqizës, por tashmë një objektiv tjetër. Pak kujt i ka shkuar në mendje se lart përbri majës së malit të Dhoksit, në lartësinë 2124 m ndodhet një nga liqenat më të bukur në Shqipëri e ndoshta në Ballkan. Ai është Liqeni i Zi. Tek ngjitesh për në qytezën e Krastës bukuria është mahnitëse, por kur ti të shikosh Liqenin e Zi ... Atëherë fjalët janë të tepërta. Ndiqeni vetë. Askush nuk mund ta besojë që ky liqen ka një thellësi 150 m. Nuk ushqehet nga asnjë burim uji.

Ndërsa kjo pamje është vërtet e rrallë. Atje poshtë në luginë mjegulla ka mbuluar gjithçka. Kjo pasuri e rrallë natyrore është ende e pashfrytëzuar. Ajo, më të shumtën e rasteve, u është dorëzuar instinkteve të shkatërrimit. Shikoni se çfarë është bërë përreth. Megjithatë bukurinë përrallore të këtij mjedisi nuk mund ta tjetërsojë askush.

Nga Liqeni i Zi zbresim në Fushë Bulqizë. Rrallë kund si këtu gjen kaq shumë tyrbe dhe vende të shenjtë të lidhura me emra shenjtorësh. Edhe brenda një lagjeje fshati mund të gjesh dy dhe tre të tilla. Bulqizakët përmendin sidomos Baba Fejzë Bulqizën, një nga shenjtorët më të respektuar në këtë zonë.

Ka filluar të bjerë mbrëmja dhe teksa largohemi dëgjojmë tingujt e një orkestre dhe një këngë grash bulqizake. Na thanë se bëhet dasmë. Dikush këmbëngul që të shkojmë dhe ashtu bëmë. Gratë dhe vajzat ishin veshur me kostume popullore dhe këndonin e kërcenin këngë dasme. Ishte një kënaqësi e veçantë.

U larguam nga Bulqiza me mendimin se diçka kontribuam për të, për banorët e saj dhe të mund të tërhiqim vëmendjen e lexuesit.

Vlerësohet Cirku i Peshkopisë


Para disa ditësh, u organizua një koktej nga qytetarë të Peshkopisë, për të përshëndetur trupën e cirkut dibran, e cila na nderoi në spektaklin e madh "Ti vlen". Pjesëmarrja ishte mbi 60 vetë të cilët kontribuan dhe ishin nismëtarë të këtij aktivitetit: ato ishin të ndryshëm si inxhinierë, ekonomistë, profesor, prindër të fëmijëve si dhe punonjës të kulturës e sportit. Fjalën e hapjes e mbajti z. Syrja Stafa përgjigjes i sektorit të shkencës dhe ish Drejtor pranë Q.K.F. Peshkopi. Më pas u këndua një këngë kushtuar Trupës së cirkut Dibran nga grupi i çiftelive të QKF. Drejtuar nga instruktori Qani Mandri një krihim i ri titulluar "Ti vlen". Më pas salla u pushtua nga muzika e vallë shumta. Ku gjatë gjithë takimit po jepej në ekran spektakli "Ti vlen". Prezantuesja Ina Savoçi recitoj një vjershë për artistin e Popullit Telat Agolli. Më pas përshëndeti trupën e cirkut drejtori i Pallatit të Kulturës, z. Veli Vraniçi. Në këtë takim nuk munguan numrat e cirkut të cilat u interpretuan me shumë mjeshtri në zhanera të ndryshme ku pjesëmarrësit u befasuan, që një shfaqje vërtet. (Pas recitimit të pranishmit i përshëndeti Drejtuesi i trupës së cirkut Agron Strazimiri).

**"Ti vlen", "Ti vlen", "Ti vlen"
Gjëmajnë lodran anembanë
Dridhet salla në Tiranë
Dridhen rrethet dhe juria
Kur del cirku nga Peshkopia
Ç'është ky cirk në shqipëri
Po të pyesësh çdo njeri
Kush atë e krijoi
Kush jetën ia kushtoi
Agron Strazimi**

**"Ti vlen", "Ti vlen" Agron Strazimir
Në të gjitha sfidat, ishe më i mir
Babaxhan o babaxhan të gjithë ty të thonë
Cirkun tonë të dashur
E nxore kampion**

sua me dëshmi përkatëse për rezultate shumë të mira të arritura gjatë këtij viti pranë Cirkut Kombëtar "Ali Xhixha" në Tiranë. Pas specializimit Cirkut Kombëtar i Tiranës erdhi në qytetin e Bulqizës dhe dha një shfaqje të përbashkët me cirkun amatorë të Bulqizës me premierën "Shpërthime Pranverore" me regji të Arjan Milukës dhe Udhëheqës Artistik Telat Agolli. Shfaqja u ndoq me shumë interes nga shikuesit. Gjatë këtyre viteve Agroni u ftua si pjesëmarrës në programet e kësaj trupe artistike e sportive.

U bënë gati 10 vjet që Agroni filloi punë pranë Q.K.F Peshkopi. Në fillim si instruktor i jashtëm dhe tani si punonjës definitiv. Duke grumbulluar fëmijë me të dhëna, të talentuar për ngritjen e këtij grupi akrobatik. Zhvillon stërvitje të rregullta dhe bashkëpunon ngushtë me prindërit e fëmijëve. Trupa e Cirkut Dibran ka 23 artist të moshës 5 vjeç e lartë. Nxënësit e kësaj trupe për rezultate të larta janë mirëpritur në Cirkun e Tiranës dhe në Shkollën e Baletit. Gjatë kësaj kohe janë dhënë shumë shfaqje nga kjo trupe si nëpër Komuna po ashtu edhe nëpër qytete të vendit tonë. Janë ftuar në spektakle, takime kombëtare e ndërkombëtare si: Për talentet e reja 1988 në Tiranë, në 30-vjetorin e Cirkut të Tiranës 1989, në 40-vjetorin Cirkut të Tiranës 1999, Fest-Lojë 2001 në Durrës, Filmim në TVSH Korrik 2005 Peshkopi, Top-Channel 20 Mars 2005, Oda-Dibrane 16 Qershor 2005 Peshkopi, Fiks-Fare 27 Dhjetor 2005 Tiranë, Festivali i humorit 16 Tetor në Vlorë, Filmim në TVSH 13 shtator 2006 Tiranë, Festivali mbarekombëtar i fëmijëve 17 Qershor 2007 Shkodër, Java e Kulturës Europiane 3 Maj 2008 Tiranë etj.



Vepriprimaria e kësaj trupe cirku ka tërhequr vëmendjen e medias së shkruar dhe vizive që nga Televizioni Publik Shqiptar e stacionet televizive private si Alsat, Top-Channell, Vision Plus, News 24 etj. Nga puna sistematike që bëhet, pjesëtarët e këtij grupi kanë bërë përparime të dukshme. Akrobati Aurel Istrefi realizon më sukses ushtrime të shkallës së vështirësisë së lartë, shumë i talentuar Erenglend Murrja realizon ushtrime akrobatike në ajër që të emocionon. Fabjola Neli në ushtrime dyshe force ka interpretuar me sukses në takimet kombëtare. Në ushtrimet plastike akrobatja e talentuar Presjada Kacani e cila me interpretimin e bukur plastik na kujton akrobatet e famshme Vitore Salaku dhe Pinea Shkurti. Kohët e fundit u zhvillua në Tiranë spektakli "Ti vlen" mori pjesë dhe trupa e Cirkut Dibran ajo arriti rezu1tate mjaft të larta, duke eliminuar grupe dhe individë mjaftë të përgatitur, në gjysmë finale dhe në finale deri sa arriti në katërshen më të mirë të spektaklit. Ndër të gjithë grupet që morën pjesë vetëm Cirkut i Peshkopisë realizoi dy performanca të reja.

Juria tha: "Qe një befasi e bukur Trupa e Peshkopisë, na la gojë hapur". Sopranoja Vikena Kamenica kur pa performancën e fëmijëve të talentuar dibranë i vlerësoi maksima1isht dhe tha që Peshkopia kishte shkëlqyer, ka patur dhe një teatër amator i cili kishte vlere të larta artistike.

Në gazetën "Rruga e Arbërit", Bujar Karoshi shkroi shënimin "Ata vlejën", i cili shkruan se "ata na bënë të ndjehemi krenarë se na tregojnë se mes nesh ka akoma njerëz që ruajnë përkushtimin dhe vullnetin për t'i bërë gjërat me dashuri dhe zemër". Gazetarja Nashide Shala në gazetën "Shekulli" 7 Janar 2009 shkroi: "Fituesi i vendit të parë u votua nga populli me vota elektronike (nëse nuk bëhet fjalë për abuzime) votimet nxorën 4 më të mirët ku në mes tyre dominonin hipnotizuesi dhe cirku i Peshkopisë. Për mendimin tim Cirkut i Peshkopisë meritonte kategorikisht fitoren, çdo gjë ishte origjinale, profesionale ku mund t'i krahasosh me akrobatët kinezë. Një rreth i largët si Peshkopia të këtë përgatitur një grup të tillë Cirkut që nuk e ka as Tirana. Më vjen shume keq që ne si popull priremi pas dukjes, pas mashtrimit dhe nuk primojmë punën, djersën. Ndoshta e kam të vështirë t'u besoj falsiteteve.

Salla e mbushur plot duartrokite gjatë cirkut dibran të drejtuar dhe të përgatitur me përkushtim nga zoti Agron Strazimiri. Vlen të theksojmë se kjo trupë Cirkut ka qenë e ftuar në shumë spektakle si në Shkodër, Bilisht, Durrës, Ulqin, Tetovë, Dibër të Madhe ku për arsye financiare nuk kanë marrë pjesë. Po ashtu ne vazhdimësi Cirkut Dibran i kanë ardhur ftesa nga Maqedonia, Mali i Zi . Tiranë etj. Prandaj me këtë rast shpresojmë se gjërat po ndryshojnë.

SYRJA STAF / HYSNI BRUÇI

Nga
**Vesel
HOXHA***

Nuk do kalonte shumë kohë, dhe nuk do ta ndjeja si në fillimet e para të punës, mënyrën e të jetuarit larg nga familja, jo se isha bërë tjetër njeri, por respekti që po më bëhej nga krahina e Kalasë së Dodës, sikur ma lehtësonte apo ma zbuste mërzitjen, ma shpërndante vëmendjen. Dita ditës i shtoja miqtë e shokët që njihja e takoja duke mos e ndërë ftohtësinë e Jabanxhiut, një fjalë turke që ka fituar qytetarinë si shumë e shumë fjalë të tjera turke, per hirë të rrethanave të njohura historike gjatë të cilave keto dy popuj bashkëjetuan në shekuj.

Të dielën e fundit të gushtit të vitit 1982, pasdite vonë udhëtova për në fshatin e lindjes, në Bllaçë. Makina nuk kishte. Edhe sikur të kalojë ndonjë e tillë thashë me vete, po të më njoh shoferi do të më marrë rrugës, i bëja qëjfin vehtës dhe kështu vendosa të nisesha në këmbë. Vendosa të shikoj prindërit, pasi kisha ca hohë pa i parë. E kisha bërë si rregull, o në kthim ose në vajtje për në ekip, të lakoja rrugën e ti shikoja. Rastësia e solli që për të vajtur në ekipin gjeologjik ku punova për gati 10 vjetë pa lëvizur, duhej të kaloja nëpër fshatin tim, ose më sakt rruga e makinës e linte në krahun e majtë, rreth 1 km larg saj. Pas 2 orësh udhëtim isha pranë fshatit të lindjes. Malorja e Kodres se Bitrit më lodhi pak. Ndërsa ecja në atë malore të vogël, mu kujtua nje ndodhi sa humoristike aq dhe e vertet. Një bashkëfshatar i imi kishte ikur prej vitesh në Stamboll. Dikur i kishte rënë ndërmend se e ka një vendlindje dhe ajo duhet vizituar herët apo vonë. Pa marrë vendimin për tu nisur, interesohet e pyet një bashkëfshatar që sapo ishte kthyer në Stamboll nga Bllaçja. A është akoma malorja e Kodrës se Bitrit? Po -i përgjigjet krejt normal ai -por me një farë habie. Lere se nuk jam duke shkuar – kishte thënë ai. Kështu gojëdhënat thonë se vdiq në Stamboll pa e parë më vendlindjen nga frika e malorës se Kodrës së Bitrit. Në të hyrë të fshatit takoj shumë njerëz, midis tyre takoj dhe shokun e fëmijërisë, Sakip Dautin. Përsëendetem më të dhe më fton të pushojmë pak, në një cep të gjelbëruar afër rrugës hyrëse të fshatit, për të zgjatur pak muhabetin. U ulëm ballë për ballë me vorrezat e fisit tim dhe të fisit të Sakipit. Të them të drejtën vorrezat e fiseve tona kanë qenë të rrethuara e të mirëmbajtura mirë ndër vite. Vonë pastaj u rrethuan gjithë vorrezat e fshatit. Ndërsa po ç'mallesha me shokun e fëmijërisë, pjesërisht edhe të jëtës studentore duke kujtuar ato vite që nuk kthehen pas, pa prituri vjen pranë nesh xhaxhai im Vexhi Hoxha. Vexhiu kishte qenë imam i fshatit Bllaçë e Poshtëme, në kohën që lejohej feja. Pas ndalimit të fesë ai vazhdoi të punoj në kooperativë, duke punuar e duke u shquar mbi të gjitha për drejtësi e ndershmëri të lartë. Kishte një vullnet të jashtëzakonshëm, lexonte shume libra dhe me të duhej kujdes në bisedë. Vite më vonë, pas lejimit të saj në vendin tonë kur fitoi demokracia, ai përsëri do të shembente fshatarëve të tij si iman, pam-

varësisht se tashmë, së bashku me familjen e fëmijët banonte në Tiranë. U kthye e jetoi në shtëpinë e mbuluar me tjerçullat që vetë i bëri, derisa ndërroi jetë, pranë fshatit dhe fshatarëve që i deshi dhe u shërbeu me aq zell e përkushtim deri në momentet e fundit të jetës. Në fillim vitet e demokracisë, mu dha rasti të marrë disa libra fetare në Medresenë e Shkupit (Shkolla e Mesme Islame "Medreseja Isa Beu"), duke ia dhënë shumicën prej tyre xhaxhat tim, Vexhiut. Kjo bëhej dhe me pëlqimin e babës, i cili tregonte një dashuri, vëmendje dhe kujdes në vazhdueshëm për të, falë përkushtimit e dijeve të tij në fenë islame.

Jepja Vexhiut -më thoshte ai -se tek ai librat zënë vend. Nuk do ta harroi kurrë gëzimin që ndjeu dhe falenderimin që më bëri. Vexhiu nuk ishte vetëm një mësues feje i aftë e shembullor por dhe punëtor i madh. I punonte truri për shumë gjëra dhe kishte një shpirt praktik. Ato ditë punonte për të bërë tjerçullat e shtëpisë. Me që nuk kishte mundësi ti blinte, se ashtu ishin mundësitë financiare të tij në atë kohë, kishte vendosur ti prodhonte vetë. Të pashë kur kalove. Thashë t'ju takoi se kisha kohë pa u parë dhe më kishte marrë malli. Desha gjithashtu të shfrytëzoj dhe rastin t'ju pyes disa gjëra që mendoj se lidhen me profesionin tënd. Të them të drejtën nuk e kuptova se për çfarë po bëhej fjalë. Ku nuk e çova mendjen, vetëm për tjerçullat nuk më kish vajtur mendja. Xhaxha Vexhiu e kam pas dashur shumë, sa mund të them, nuk e ndaja me babën. Unë e kuptoja se dhe ai më deshte shume. Nuk thonë kot se ta ndjen zemra kur tjetri të do. Nejse, le të kthehemi te tjerçullat, se do ndalem në momente të tjera për këtë personalitet të fisit e fshatit tim të lindjes. Unë kam filluar një punishte të vogël për të prodhuar tjerçulla. Me të dhënat e mia mendoj se argjila ose bota siç i themi ne fshatarët në gjuhën popullore, është e mirë. Por nuk e di ç'thotë shkenca –e mbylli pyetjen Xhaxhai im Vexhiu. Kur u ngjita Kodrës së Bitrit, në anë pashë germimet që ishin bërë dhe nuk e kuptova pse ishte hapur. Tani e kuptoj se atë gropën e pasqenit hapur ju. Po -përgjigjet xhaxhai -unë e kam hapur. Unë -i'u drejtova atij -të them të drejtën nuk kam njohuri të plota për llojë të argjilave që përdoren për tjerçulla, pasi aplikohen studime specifike dhe duhen bërë analiza për vetit fiziko – mekanike, për të thënë në se janë të mira ose jo. Megjithatë -vazhdova unë me një buzëqeshje të lehtë -këtë punë do ta rregullojmë, që ju vertet të jeni të qartë dhe në anën shkencore. Për këtë punë ka eksperiencë Sakipi –vazhdova unë duke ju drejtuar atij dhe Xhaxhait. Sakipi kishte filluar punë në gjeologji në atë kohë ne zonën e Çidhnës, ku kryenim punime si Ekspeditë (nëpërmjet Ekipit të Materialeve të Ndërtimit) edhe për argjila, si lëndë e parë për çimento, por jo të asaj cilësie siç kerkohet për tjerçulla. Që ta mbyllë shkurt bisedën, së bashku me Sakipin dhe Nexhat Hysën e ndihmuam që të gërmoj e prodhoj material argjilor për tjerçulla në shtresën më të mirë, në afërsi të kokës së Livadhit të Bitrit, pranë rrugës këmbësore që të çonte në fshat, në mezin e malorës që trembi Stambolliun e Bllaçës. Analizat ja kryem të gjitha, duke e keshilluar që

"brumi i argjiles" i përgatitur dhe i formësuar sipas dëshirës për tjerçulla, duhej të thahej në diell sipas rregullave dhe të mos piquej shumë, për faktin se perqindjet e kalciumit dhe te hekurit e diktonin një gjë të tillë. Kjo shtresë argjilore kishte një trashësi të konsiderueshme, shtrirje të madhe dhe kontrollonte nga poshtë të gjithë kodrën e sterzgjatur deri në lumin Drin, mbi të cilën ngrihet fshati im i lindjes, fshati Bllaçë. Kjo shtresë kontrollon ujrat nëntokësore që ka zona ku shtrihet fshati. Të gjithë ujrat sipërfaqësore, përfshirë dhe ujit e shiut, vazhdojnë të depertojnë në thellësi të tokës deri sa takojnë këtë shtresë dhe aty ndalen, se ajo nuk e lejon kalimin e ujit më në thellësi, është e papërshkueshme. Të gjitha burimet natyrore të fshatit, edhe pse jo të shumta në numër, si Kro i Milecit, Kro i Arrave, Kro i Derit, Kro i Lajthisë, Kro i Sadikut, Xherizet e shumta ne Vneshtë, në fundin e tokës time dhe tokës së Xhelil Ferrës (brrakat), etj. etj., kanë poshtë tyre shtresën argjilore në fjalë. Të më falë lexuesi se u zgjata pak dhe ndoshta hyra në një brendi jo shumë të kuptueshme për lexuesin e thjeshtë, për hirë të terminologjisë profesionale që duhet të përdorja, por vendlindja e ka një magnet të fuqishëm e të pa dukshëm për të gjithë ata që nuk banojnë aty ku kanë lindur. Kësajsoj dhe unë nuk i shpëtoj veprimi të kësaj fushe magnetike. Le të kthehemi tek biseda me xhaxha Vexhiun dhe të kuptoni pse ajo më ka ngelë në memorie prej kaq vitesh pa u fshirë nga kujtesa. Në lidhje me dijet në përgjithsi, dhe raportet brenda kësaj fushe, dëgjoni t'ju them një Hadith – vazhdoi ai:

- Safuan ibn Asal el-Muradi, një shok i Profetit (a.s.) ka thënë: "Unë shkova të shoh Profetin dhe e gjeta atë të mbështetur në një shtrigo të kuqe. I thashë: O i dërguar i Allahut, unë kam ardhur të të kërkoj dituri!" Ai u përgjegj: "Mirë se erdhe, tek ai që kërkon dituri. Engjëjt e bartin në flatrat e tyre, atë që kërkon dituri!" Njeriu duhet ta kërkoj diturine, siç thotë Profeti ynë, nga djepi deri në varr. Pra tërë jetën e Tij –perfundoj Ai.

Sa herë do ta takoja Xhaxha Vexhiun, aq herë prej tij do ta mësoja një thënie të artë. I tillë ishte ai, njeri zemër madh, që e deshi jo vetëm familja e fisi por një fshat dhe një krahinë e tërë. Ai ishte një njeri i thjeshtë, ai ishte një filozof popullor.

Bën mirë që i shikon prindërit mu drejtua Sakipi. Me këtë rast shikon e takon edhe shumë të tjerë. Nuk duhet të bëhemi si ai bashkëfshatari që vdiq në Stamboll pa e parë vendlindjen nga frika e malorës së Kodrës së Bitrit. Vend-lindjen duhet ta duam para se të plakemi se at-here e duan të gjithë, por është vonë, dhe at-herë do shohësh më shumë varre se të gjallë. Fjalët e Sakipit më preken, ndonëse nuk shquhej shume për figura letrare në shkollë, por fjalët i rënditi më mirë se unë. Kudo që të vesh dhe në çfardo posti te ngjitesh apo titull të fitosh, vendlindja e ka një emër, e ka një qoshe, e ka një vend të pazëvendësueshëm..!

Atë natë u ç'malla me prindërit dhe me vizitorët e pasdarkës. Pasi u larguan mysafirët nëna në një moment më pyet: Si po të duket Kalaja e Dodës, a po lodhesh shumë ma-levë të Korabit, me njëzëit si shkon,



Pamje e Gjipeve të Malit të Bardhë (Maja e Pelpanikut, 1966 m).

më duket se je pershtat, sikur i ke lënë pak ankesat? Po i përgjigjem, jam ambientuar, shpesh më ftojnë dhe nëpër shtëpia dhe sikur e shpërndaj mendjen, e largoj mërzinë. Si ndihesh bir atje? Si në shtëpinë time nanë, i përgjigjem! Mirë -mirë më tha nana, shko rrallë e mos e tepro bir! Të nesërmen u ngrita herët dhe u nisa për në Sorokol. Atje më prisnin punëtorët, sondat, galeritë, pusët, kanalet dhe rievimi i detajuar që do të bënim me Xhelal Sulin. Kisha lënë takim me të tek Lapidari i Shumbatit. Afer Ligenit apo rezervuarit ka patur një Lapidar. Nuk di ne se është akoma, por di se ne e kishim si pikë referimi. Në orën e caktuar takohemi të dy dhe pas përsëritjeve të rastit nisemi. Edhe pse unë propozova të pushojmë pak dhe ndërkohë mund të kalonte ndonjë makinë, Xhelali kundërshtoj dhe vevendos që të nisemi. Nuk kemi asnjë siguri dhe na kap vapa. Në atë kohë rruga e Sllovës për në Kala të Dodës nuk ishte hapur akoma. Kështu, siç e përdorim rëndomë një shprehje popullore, vetëm "makina e babës" ishte e sigurt, e na çonte në destinacion.

INTERMEXO E ARTË

Me Xhelal Sulin isha njohur në distancë vite më parë, ndonëse na ndante vetëm një përrua në mes, Përroi i Gramës ose siç jemi mësuar ti themi ne vendasit, Përroi i Bllaçës. Shpesh në zhargonin e përditshëm për të nënkuptuar këtë përrua thirrej edhe ndryshe "Bllaçja". Jo rrallë kur kishte rebeshe shiu përdorej shprehja, Bllaçja sot ishte e pakalueshme. Ose, sot fëmijët nuk do ti dërgojmë në shkollë –thonin prindërit, se ka shumë uji Bllaçja. Kjo ndodhte kur shkonim ne shkollën 7 –vjeçare të Fushë Alies të asaj kohe. Por dhe në shkollën e Fushë Alies, Xhelalin nuk e pata njohur, pasi ai ishte më i madh se unë në moshë. E megjithatë, edhe pse ishim aq pranë, unë Xhelalin e njoha vite më vonë, pasi kisha mbaruar studimet e larta dhe kisha filluar punë në Bulqizë. Ja kisha dëgjuar zërin kur thonë. Xhelali kishte mbaruar Teknikumin e Minierave dhe të Gjeologjisë në Prenjas të rrethit të Librazhdit. E kishte mbaruar me Medalje Ari. Ishte diplomuar teknik i mesem Makshejdër. E theksova me qellim medaljen e tij dhe kjo duhet thënë me zë të lartë, sidomos për njerëz modest si Xhelali që vetë nuk bëjnë zë. Unë nuk besoj se shkolla e Fushë Alies e ka të shkruar në ndonjë cep se nga kjo shkollë ka dalë një nxënës që e ka nderuar me medalje Ari dhe ky është Xhelal Suli.

Teknikumi i Prrenjasit ishte një shkollë që, për nga koha kur u hap dhe për nga cilësia e specialistëve që nxori, mund të thuhet se ishte një Universitet i Vogël. Kjo shkollë, në anë të fushës së Domosdovës, ballëpërballë me Qafën e Thanës, me ato dy godinat karakteristike e të bukura pranë e pranë njera tjetrës, me një plejadë pedagogësh të shkolluar jashtë shtetit, kryesisht në vendet e lindjes, nxori në dekada kualitete profesionale në fushën e Gjeologjisë, Minierave, Shpimit dhe Makshejderisë, një pjesë e mirë e të cilëve dhanë dhe japin një kontribut real në përparimin e vendit. Këtu është vendi të them një të vertetë, dëshmitar i të cilës jam edhe unë, autori i këtij shkrimi. Kur mbarova shkollën e mesme ne Prrenjas, me maturantët u organizua një mbrëmje, ku midis të tjerave, u ndanë diplomat dhe u festua fitorja e shkollës tonë në konkursin kombëtar në Tiranë. Ky organizim përkonte pra edhe me fitoren e grupit perfaqësues të Shkollës së Mesme të Minierave dhe të Gjeologjisë në konkursin e rinisë "Teknika dhe Jeta", organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës në Tiranë, ne fillim verën e vitit 1970. Midis 28 shkollave të mesme profesionale të asaj kohe, shkolla jonë zuri vendin e parë. Në grupin e fitorës bëja pjesë edhe unë. Po ashtu ishin pjestarë të grupit dhe zotrinjtë, nxënësit e talentuar, Pajtim Bello, Gole Vasha, Çerçiz Durmishi dhe Gafurr Muka. Që të gjithë këto e mbaruan me rezultate të shkëlqyera shkollën e Prrenjasit, me rezultate të shkëlqyera edhe studimet e larta dhe sot janë personalitete të shquara shkencore, në institucione qëndrore ne fushën e Gjeologjisë dhe të Minierave, në Tiranë. Me që unë isha më i moshuari isha caktuar si kryetar i grupit, kësajsoj paraqitem për të marrë certifikatën e nderit të akorduar për vendin e parë. Drejtori i Shkollës, Ing. Minella Gjermani (mund të them pa frikë se ishte sipas meje modeli i drejtuesit që kam njohur në jetën time deri tani. Serioziteti dhe autoriteti i atij njeriu te impononin respekt), mu drejtua me këto fjalë: Ju Vesel, e njihni Xhelal Sulin, është nga ana Juaj, është nga Fushë Alia. Të jem i singert, me lexuesin, unë i thash që nuk e njoh. Vetëm emrin ja kam dëgjuar. Drejtori i shkollës në ligjeratë të drejtë më tha: Për ju dhe shokët e grupit kemi për të thënë vetëm fjalë të mira...nderuat vehtën....nderuat famlijet tuaja... na nderuat shkollën...na nderuat mësuesit...na nderuat në Ti-

ranë etj. etj... por nxënës si Xhelali.... do të ngelën gjatë në memoria-lin e kësaj shkolle. Nga ajo kohë kurioziteti për ta njohur Xhelalin ishte i pranishëm çdo ditë të punës në Bulqizë, gjersa pastaj, pas njohjes, me ndihmën e Kryegjeologut, u sistemua në punë pranë Ekspeditës Gjeologjike te Peshkopisë, si to-pograf (makshejder), ku shkëlqeu në të gjitha aspektet, duke na vënë mbi baza të plota shkencore azhromimin e punimeve gjeologo - kerkuese e zbuluese jo vetëm të ekipit të Heku-rit, por të gjithë ekipeve të ekspeditës tonë. Cilësia e punës e afirmoj shumë shpejt edhe në ekspeditën tonë, siç e kishte prezantuar vehtën edhe në ekipet dhe ekspeditat e tjera të rre-theve të Matit e Dibrës.

...Le të kthehemi te udhëtimi me të. Pasi arritëm në qafën e Kaushës, në vëndin e Elez Isufit, bejmë një pushim. Aty ku ne u ulëm për të pushuar, ç’lodhnm edhe sytë, pasi të shpaloset një pamje madhështore nga të gjitha anët. Duken me rradhë e hijerëndë, shpati matanë Ve-leshicës – një pjesë e mirë e Kalisit, Sorokoli -me një pjesë të fshatrave të Kalasë në këmbët e tij, Mali i Bardhë i Gjipseve -me fshatrat Dip-jakës, Venishtit, Sllatinës,Vleshës dhe Kallës në rrezën e vet dhe gjithë korniza karbonatike e pjesës përen-dimore te rrethit të Dibrës, nga Malë-sia e Reçit e deri ne afërsi të Malë-sisë së Shupenzës.

...Lë të shkëputemi pak nga pushi-mi i udhëtimit të asaj dite, nen rrezet e diellit të mëngjezit në Kaush së Sllovës dhe të kthehemi pas në kohë, në këtë vënd, por në kushte të tjera klimaterike. Në nëntorin e vitit të kaluar (1981) në këtë vend me Xhelal-in na kishte zënë nata. Ishim nisur vonë nga ekipi i Sorokolit dhe ke-sisoj nata do na zinte në rrugë. U nisëm natën pasi duhej të udhëtoja të nesërmen për Tiranë ku isha i an-gazhuar me raportin e temës qeveritare te hekurit pranë Institutit të Kerkimeve Gjeologjike, Tiranë. Kishim planifikuar të shkonin në fs-hat, jo në Peshkopi. Rrugës na zuri bora dhe nje stuhi e pa parë sa, kur po kalonim në sheshin e Kodrës së Kaushës, era sa nuk na ngrinte në hava. Në një nga keto momente, mua më rrëshqet këmba e djadhtë, dhe e ndrydh pak, sa fillova të ec me vësh-tirësi, ndërkohë që për të vajtur në fshat na duheshin edhe 2 orë të mira. Xhelali u friksua më shume se, të papritur at ishin të mëdha. Atij i binte barra të zgjidhë situatën, unë konsi-derohesha “i plagosur”. Mbj mend një thënie të Tij që vlenë ta tregoj në dialogun që bëmë atë natë të llahtarshme. Ah, sikur të kemi nje aparat, që të njoftojmë se ku jemi e të na vijjë në ndihmë. Shiko andrra me sy hapur Xhelal, ne nuk lidhemi dot me tela se keputen çdo ditë, ti na kerkon dhe aparat! Mua veç ky aparat ma zgjidh problemin se ne shpinë unë nuk të mbaj dot. Ndoshta ishte për të qeshur por që te dy e ruajtëm seriozitetin. Tani që kanë kaluar vite, aparati që lutej e kërkonte Xhelali është realitet. Kur celularët u bënë si një diçka e zakonshme, më thotë shpesh kur e takojë, hë mor, paskam pasur të drejtë për aparatin! Keshu e ke ti Xhelal i them unë me humor, ja fut kot e të del plotë. Kësh-tu do mbrohet kundërshtari -më përgjigjet po me humor ai, dhe nisim kështu shtruar bisedën duke dalë shumë pak raste jashtë livadhit tonë të përbashkët, gjeologjisë e to-pografisë që u kemi kushtuar jetën, dhe për të cilat ndajmë dhe kujtimet e pafundme!

(Vijon numrin e ardhshëm)

Dihet tashmë se në vitin 1844 kur është zhvilluar beteja e famshme kundër ekspeditës turke të komanduar nga Hajredin Pasha nuk ka patur shkrim e këndim. Kështu që kronika e luftës është bërë nëpërmjet kangës...

165 vjet më parë Protagonistët e betejës së Drinit 1844

Sipas variantit të vjetër të kangës kushtuar luftës kundër Hajredin Pashës

Nga: SAKIP CAMI

Dihet tashmë se në vitin 1844 kur është zhvilluar beteja e famshme kundër ekspeditës turke të komanduar nga Hajredin Pasha nuk ka patur shkrim e këndim. Kështu që kronika e luftës është bërë nëpërmjet kangës, e cila është trashëguar nga brezi në brez, nga konaku në konak.

Tani kanga është shkurtuar për tu kënduar në tre minuta dhe për tre minuta nuk del se kush janë protagon-istët e kësaj lufte që ka mbetur në historinë e Dibrës dhe të Shqipërisë.

Në Historinë e Shqipërisë (Volu-mi II) viti 1984, faqe 128, shkruhet se Dibra kishte kundërshtuar masat e reja qeveritare turke. Malsorët e Di-brës, të mbledhur në kuvend kishin dhënë besën për mbrojtjen e lirive që kishin gëzuar deri atëhere. Malsorët dibranë të udhëhequr nga Cen Leka i zunë rrugën ushtrisë turke të komand-uar nga Hajredin Pasha duke u rresh-tuar gjatë lumit Drin. (Drin i Zi). Në përlshjen që u zhvillua në fshatin Gjoricë, u bënë ballë me heroizëm sulmeve të ushtrisë turke.

Duke vënë në dukje heroizmin e dibranëve në luftime, përfaqësuesi francez në Janinë shkruante më 14 dhjetor 1844 „është luftuar pëllëm-bë për pëllëmbë dhe me një ven-dosmëri të atillë sa që edhe gratë e fëmijët qenë rreshtuar me luftëtarët.”

Për t’i shpëtuar terrorit të egër të ekspeditës osmane një pjesë e madhe e popullsisë u detyrua të braktiste shtëpitë e të fshihej në male.

Është për të ardhur keq që histo-ria e Shqipërisë i kushton kësaj lufte vigane vetëm dy rreshta, duke e ren-ditur së bashku me luftërat e tjera të periudhës, në një kohë kur vetëm shtypi i kohës dhe përfaqësuesit e huaj i kanë kushtuar faqe të tëra.

Pa mohuar rolin e Cen Lekës në këtë betejë, nuk del roli i protago-nistëve të tjerë që janë jo pak por të gjithë përfaqësuesit e nandë maleve të Dibrës dhe veçanërisht të Grykës së Vogël dhe të Grykës së Madhe, ku u zhvillua beteja.

Le ta fillojmë me Cen Lekën. Pa-sha (gjeneral) nga fshati Zogje, ardhur nga Turqia për këtë betejë për tu përdorur nga turqit në dëm të bashkëf-hatarëve të tij, por ai nuk pranoi.

Fshatarët e Grykës së Vogël, Grykës së Madhe dhe të Maleve të tjera të Dibrës morën pjesë në bete-jën kundër Hajredin Pashës në Fush-ën e Gjoricës, ose në Fushën e Thatë siç njihet nga populli, vendi ku u zhvillua kjo luftë.

Ajo u udhëhoq nga figura të njo-hura si Sheh Mustafa Zërqani, Cen Leka, Mahmut Cami, Rizvan Alla, Mane Cami, Salë Markja, Salë Demiri, Faslli Malja, Hazis Dema, Nel Hoxha, Shaqir Daci, Abdi Sturcja, Shaqir Jegeni etj.

Organizimi i kundërofensivës ndaj ushtrisë së Hajredin Pashës ishte në bazë të një plani të mirëfilltë ush-tarak dhe konkretisht organizimi i një dare rrethuese nga Ura e Topojanit, Meja e Kalasë, Qafa e Çerenecit, Kodra e Golovishtit, Ura e Spiles, Vrabici, Zupa, Elefca, Spasi, rrethim ky që e detyroi ushtrinë turke që të

linte në fushën e luftimeve jo pak por 12 mijë ushtarë dhe të tërhiqej nga kishte ardhur.

Fusha e betejës së madhe ishte Gjorica, e cila ishte një ranishte e sheshtë, plot me plepa të mëdhenj shekullorë në anë të Drinit.

Këtu ishte fronti kryesor që shtri-hej nga kodrat e Viçishtit deri tek Ura e Topojanit. Malësorët shumica kishin hypur nëpër plepa dhe ishin maskuar me gjethe e degë. Armët e malësorëve ishin disa pushkë të gja-ta që qëllonin larg. Turqit kishin disa pushkë të shkurta që quheshin “sul-tane”. Popullsia vendase ku zhvil-loheshin luftimet ishte tërhequr në malet e Bllacës.

Turqit kishin vënë në ballë të ush-trisë së tyre Cen Lekën dhe dy shokë të tij duke menduar se dibranët nuk do të qëllonin mbi Cenin, por këtë e zgjidhi vetë Ceni i cili u thirri shokëve: “Qëlloni mue të parin e mbasandaj grini turqit”. Sa mbaroi fjalën Ceni, lufta ndizet me furi.

Ceni me dy shokët e tij shmanget dhe në përlshje e sipër shkëputet nga ata. Ushtria turke ra deri rreth Drinit dhe filloi të futet me rroba në ujë. Malësorët i prisnin derisa fu-teshin në ujë, pastaj u binin dhe i vrisnin me precizion.

Gjatë ditës së parë shtatë herë u mbush plot e përplot Drini e të sh-tatë herët, të gjithë sa u futën mbetën të vrarë.

Artileria turke goditi me ashpërsi të gjithë zonën por pa rezultat. E njëjta rezistencë bëhej edhe në qafën e Çerenecit, tek Ura e Spiles e kudo. Sheh Mustafa qëndronte në front me malësorët, Hazis Dema ishte pranë tij. Bien në fushën e luftimit Mus-tafa Jakimi në Gjoricë dhe Musa Iz-vira tek Ura e Spiles.

Populli e ka mishëruar në kangë këtë luftë heroike: Ja si e përshkruan ai Cen Lekën:

*Hajredin Pasha , mor hajvan
Nuk shitet Ceni me alltan
Cen Leka vjen në kamë
U thurret shokëve prej matanë
Unë pale a mun vi
Po ju bini qenit t’zi
Krajsi pushka keistikami
U kuç Drini me gjak nizami
Hajredin Pasha taj mor shop
Shajfi t’vramit si bajnë not
Si bajn not e lakaçajten
Xhimsat’u vranë, xhimsat’u majtën.
Ju mor male tungjatjeta
Burrë i mir’ kish qenë Cen Leka.*

Figura mjaft interesante dhe luftëtarë të sprovuar janë Hazis Dema dhe Kurt Mete Dema nga Homeshi. Djemtë e Mete Demës që luftoi krahas Ali Pashë Tepelenës janë edhe në ballë të kësaj lufte. Ja si përshkruhet roli i vëllezërve Hazis e Kurt Dema:

*Po pyet Pasha kë kanë të parë?
Hazis Dema asht kumanar.
Kush drejton keistikami?
Hazis Dema e Sheh Zërqani.
Haziz Dema sy përgjak
Vall mos të duken malet pak?
Ti mor Kurt, mor im vëlla
Merr yrysh e bjer nat’ va
E mos shif për mrapa
Se taj t’ka ba Mehmet Aga*

Mustafa Jakimi nga Shtushaj është një hero i vërtetë që lufton edhe me një këmbë, pasi është i plagosur. Mustaf Jakimi mustaqe verdhë Ban irish e ze nat’ dardhë Qiti malet faqebardhë Karafilja e Mustaf Jakimit Vret topçijtë e Hajredinit Mustaf Jakimi me nji kam Ja vret Pashës shumë nizamë

Salë Markja është një udhëheqës i vërtetë popullor. Sali Aga siç e thëriste populli, me dy kulla një në Zogje dhe një në Bofmollë të Di-brës është një gur xhevahiri në gjer-danin e madh të historisë së bashku me Sali Demirin e Çidhnës.
*Oj Gjoricë, qofsh e shkretë
Luftë të madhe ban me mbret
Gratë e Zogje, gratë e Bllacës
Dilni para Sali Agës*

Siç e theksuam edhe në fillim në këtë luftë kanë marrë pjesë të gjithë dibranët. Por organizatorë kanë qenë Sheh Zërqani dhe Hazis Dema.

*Sheh Zërqani në kalë të zi
Shembi malet e ra në Dri
Sheh Mustafa fjalë ka çue
Hazis Dema me m’nimue
Sheh Mustafa fjalë ka çue
Thuaj Kaloshit me m’nimue
Salinë e Llanin me m’i çue,
Kanë rrok armët e kanë shkue”.*

Pra duket qartë nga kanga roli or-ganizator i Sheh Mustafës nga Zërqani, i këtij kleriku patriot me fuqi mistike, por njëkohësisht duket qartë edhe gadishmëria e Llan Kaloshit nga Dibra e poshtme për të ardhur së bashku me trimat e tij.

*Llan Kaloshi i hipi atit
S’i trembet pushkës as taksiratit
Ditën e martë u zu nizaja
Hajredin Pashën e ka xhet belaja
E ka xhet belaja si e ka xhet
Nand Malet e Dibrës janë lidhur me vdekë
Lidhur me vdekë, lidhë të tanë,
S’ningjojnë Malet me dhanë nizamë.*

Në këtë betejë legjendare ka edhe shembuj të mirëfilltë heroizmi dhe patriotizmi si ai i Ahmet Lokës nga Sopot i Grykës së Madhe dhe i Can Bajramit.

Në fshatin Sopot të Grykës së Madhe në Dibër bëhej dasëm. Mar-tohej Ahmet Loka. Njerëzit ishin mbledhur nga të katër anët për dasëm. Por hasmi shkeli në prag. Turqit nisën drejt Dibrës një eks-peditë të madhe ushtarake me në krye Hajredin Pashën. Nandë Malet e Dibrës banë thirrje për t’a pritë Hajre-din Pashën me luftë. Gryka e Madhe si dhe malet e tjera të Dibrës u përfshinë në këtë luftë. Ahmeti e la dasmën dhe nusen e re të sapo ardhur dhe pas tij të gjithë dasmorët. Ah-meti nuk u kthye më, mbeti në luftë, në betejën e Fushës së thatë të Gjoricës në qershor të vitit 1844.

“Ç’janë ata që luftojnë në gropa?
Can Bajrami e Ahmet Loka
Or Ahmet ç’e bane Canin
Kokë për kokë me kapëdanin
Ahmet Loka ka lan’ nam
U ba dhandër n’istikam.”

Gruaja e Ahmetit në shenjë res-pekti vuri në kokë shaminë e zezë dhe qëndroi e virgjër, e pamartuar deri në fund të jetës.

Po kështu edhe Rizvan Alla dhe Fasli Malja shquhen për luftë bur-rërore ballë për ballë me turqit.

*Rizvan Alla me sakorre
Paska bamun njizet vorre
Rizvan Alla me magore
I pret turqit me sakore
Kush ja prajshi festen Pashës
Fasli Malja , plaku i Krajkës*

Nga vetë kanga kuptojmë rezul-tatet e kësaj beteje dhe përgjigjen që i dha populli i Dibrës.

*Hajredin Pasha, mor brek zi
Taj taborrët të metën në Dri
Hajredin Pasha mor krajshenejk
Nuk asht Dibra Selanejk
Selanejk e Prelepe
Çish kërkove, n’Dibër e xhete
Hajredin Pasha ku e ke lanë atin?
Nat’ Spas më ka met’ i ngrati
Hajredin Pasha ku i le taborrët?
Besa n’Dibër , nëpër llogore
Hajredin Pasha ku e ke lan urdinë?
Të gjithë në Dibër, besa m’i kan gri
Hajredin Pasha mor hutaç
S’rrajfen malet me kërbac*

Krahas rezultatit final del edhe merita e pamohueshme e organiza-torëve të saj Sheh Mustafa dhe Sali Demiri.

*Hajredin pasha nji sygogël
S’ke njoft Çidhën e Gryk’ të Vogël
Me barut ta djegin koklën
Hajredin Pasha ku e ke lanë atin?
Nat’ Spas më ka met’ i ngrati
Hajredin Pasha ku i le taborret
Në fushë të Gjoricës nëpër llogoret
Krejt në Dibër m’i kanë gri
Jo ma pak se dymbëdhjet mijë
N’istikame, n’vorr pa hi
Të nandë malet kush i prini
Sheh Mustafa, Sali Demiri
Nandqind vorret kush i bani
Dibra mbarë edhe Zërqani.*

Për mbrojtjen e tokës amtare kumbojnë thirrjet: “ besë a besë”. Kush nuk i qendron besës, edhe toka nuk e pranon. Kjo besë nxit heroizmin masiv, karakterin e virtytet e larta të dashurisë për atdheun. Luf-ta zhvillohet e ashpër dhe burrërore. Luftëtarët përballen me vdekjen pa logaritur asgjë. Flamuri (bajraku) qëndron në ballë të luftës.

“Banë besë plak e i ri/ Banë yrysh e ranë n’Dri/ Ranë në Dri me gjithë bajrak, (flamur)/ E mbushën Drinin plot me gjak...”

Në këtë betejë u vranë 2500 di-branë. Vetëm Gryka e Madhe pati 106 dëshmorë. Turqit pas kësaj beteje për hakmarrje dogjën mbarë Grykën e Madhe dhe Grykën e Vogël. Ja si thotë kënga që tregon për këtë djegie masive:

“Nga Topojani në Xhitet/ Asnji shpi nuk paska mbet, Luftëtarët, të tërhequr në malet e Bulqizës dhe në Prat, për një muaj nuk arritën të sho-hin dy krahinat nga tymi i gër-madhave. Peshën më të madhe të Luftës së Drinit dhe sulmet e fur-ishme të turqve i mbajti Gryka e Madhe bashkë me Grykën e Vogël. Kjo luftë tregoi unitetin e nandë maleve të Dibrës dhe rolin e tyre të madh për mbrojtjen e trojeve amtare.

Sjellja shekullore verteton se pylli simbolizon shenjterine, nga ana tjetër kjo shenjtëri e gjelbër në këto 15 vite të lirisë në pjesën më të madhe të vendit është prerë djegur e sakatuar.

Nga HAKI KOLA

Përse në vendet e shenjta, qysh se kujtohet e kendej, brez pas brezi, njerëzit si shenjen me të dukshme të shenjterise e paprekshmerise se tyre kishin mos prerjen e drureve? Kudo ku shihen drure të mëdhenj e të vjetër, ajo që të vete në mendje është prania e një vendi të shenjtë. Kjo tek ne, shkon deri tek e cuditëshmja dhe e pabesueshmja, psh myslimanët respektojnë ish pyllin e kishës, duke e emërtuar atë vakëf. Vakëfi i Kishes së Lurës tek Guri i qytetit në Selishtë të Dibrës mund të jetë mbi 300 vjecar, dhe megjithëse cdo gje per rreth tij është prerë teresisht, pothuaj në gjithë pyjet e Selishtës, Vakëfit të Kishës nuk i është prekur qofte edhe një dege, megjithëse askush nuke mban mend kohën kur kisha ka qenë në atë vend. Kur shteti e dha të pritej me plan para dhjetë vjetësh, komuniteti lokal i tëri mysliman nuk pranoi të vihej damka e shërbimit pyjor mbi drurët e shenjtë. Sjellja shekullore pra verteton se pylli simbolizon shenjterine, nga ana tjetër kjo shenjtëri e gjelbër në këto 15 vite të lirisë në pjesën më të madhe të vendit është prerë djegur e sakatuar. Mos kjo sjellje me pyllin është dëshmi se sa larg jemi nga paganizimi, dhe respekti e ruajtja e këtij shenjtori është shenja e parë e rruges drej civilizimit. Mos ndoshta ne e respektojmë shenjtërinë e pyllit, po ashtu si njerëzit e lashtë respektonin perënditë. Përse ndodh ndryshe me shoqëritë e evoluara Europiane. Si do të sillemi ne me pyllin, kur të jemi bërë europianë? Përse Europianët e duan pyllin? Përse e duan detin? Çfarë mendojnë dhe ndjejnë ata për këto pasuri të natyrës? Çfare ndejme kur i permendim, apo pergatitemi per një vizite në pyll apo në det. Një grumbull druresh apo sasi uji gjithmone shoqerohet me një reagim deri në pasthirmë. Perceptimi i ketyre pejsazheve ka evoluar bashke me njerezimin. Ata kane bashkejetuar, dhe sipas stadeve të zhvillimit jane afruar apo larguar, ashtu sic kur njerezve u eshte dashur për të prerë druret apo ngrene peshqit per të mbijetuar. Ato qe jetojne aktualisht duke perdorur pyllin apo detin, jane pothuajse pjese e bluse e të gjelbres, ketyre dy enigmave e mrekullive të globit, që kur mungojne në hapësirë të gjërë si psh në Bjeshket e Nëmuna, vendit i vihet nofka i nëmun. Nëse ato bjeshkë do të kishin pyllin, ma don mendja se do ti quanim të shenjta. Mendimi i bariut, druvarit apo peshkatarit duket se ka dicka të ngjashme me objektin e punës: shkojnë në pyll për të punuar. Bregdetasi apo malesori janë pjesë e detit apo pyllit, kane mjaft kohë për tu dashur e për tu grindur, për të bashkëjetuar e divorcuar, mbajtur djegur e mbytur njëri tjetrin. Më duket se reagimi nga ana e tyre është një shenje e shkallës së evolucionit dhe e afrimit me shoqërine civile, shkallë e afrimit drejt shoqërive të civilizuar perëndimore. Nuke e di

Shenjtori i gjelbër



edhe sa kohë do të na duhet të behemi vizitore të pyllit, ashtu sic ka me shumicë ne vendet e civilizuar. Puna ndryshon me vizitoret. Dhe ndjesia është e ndryshme kur vizitojnë xhunglën, nga ajo kur vizitohen sekuojat gjigande të kalifornise apo pylli i Dajtit, Liqenet e Lurës e Zerqanit, Thethi, Valbona, Hotova apo Livadhi i Arushës në Vermosh. Banori i sotem i qytetit, pavaresisht nga origjina e mosha, here pas here kerkon të behet vizitor i pyllit apo detit. Ai shkon në kohën e tij të lirë e mendja ta don se shkon të shlodhet. Mos është ndoshta mërmërima e erës në gjethe që na tërheq drejt pyllit dhe përplasja e dallgëve drejt detit? Dhe duke përjashtuar atë si objekt pune e duke e trajtuar si objekt i mbushjes së jetës pyetja mbetet: përse shkojmë në pyll? Përse shkojmë në det? Kostoja është e konsiderueshme: duhet të marrësh makinën ose trenin, të paguash për naftën ose biletën dhe të shpenzosh kohën, këtë komoditet të çmuar, shpesh të kalosh gjithë ditën, bashkë me nevojën për pajisjet e domosdoshme ... Menaxhuesit e këtyre vëndeve duhet të mendojnë se për drejtimin e tyre dhe për çdo pajisje, përdoren paratë publike, buxhetet e autoriteteve lokale - të gjitha llojet e

gjërave që nuk mund të sigurohen lehtë. Në këtë sektor ku gabimet janë të papranueshme – të krahasueshme me menaxhimin e resurseve ujore ose cilësinë e ajrit- është e lehtë të shikosh se të njohësh kërkesën është e domosdoshme. “Përse shkojmë ne në pyll?”. Përgjigjet që ne marrim janë të përgjithshme: “Ne shkojmë në pyll, sepse e pëlqejmë atë”. Kjo “atë” duhet të studjohet. Çfarë është ajo që na pëlqen në pyll? Çfarë duhet të përpiqen të ruajnë menaxherët, kundrejt rrezikut për ta shkatërruar pyllin ndërsa përpiqen për ta ruajtur atë? Sepse ky përemër i vogël “atë” në fakt, do të thotë gjëra krejt të ndryshme. Disa vijnë për të kërkuar qetësinë ose një cilësi të veçantë të qetësisë. Kështu ata e karakterizojnë pyllin në terma që lidhen me të. Të tjerët vijnë për ngjyrat, dritën, pejsazhet; duke kërkuar kështu kënaqësi vizuale. Të tjerë akoma kërkojnë shijen e veçantë të pyllit që i tërheq ata: duke përdorur ndjesinë e të marrurit erë. Kjo e fundit, jo si dy të parat, nuk është një ndjesi mendore (dikush nuk mëson të flasë ose të lexojë me këtë ndjesi), është e vështirë për të gjetur fjalët e sakta për ta përshkruar ... E gjithë kjo gjë bëhet dhe më e komplikuar kur juve ju thuhet se njerëzit shkojnë në pyll

Pylli zgjon emocion dhe ndjenjë tek çdokush, ai ka një dimension simbolik, një thellësi që është pjesë e fuqisë së tërheqjes dhe që nuk është në asnjë mënyrë pjesa më e vogël

për t’ju përgjigjur stimulimit të prekjes: përkëdheljes së erës, së bimëve, sensacionit për të ecur këmbëzbathur (si përshembull në plazh)... Situata do të mbetej zbavitëse, nëse percpsionet tona ishin të kufizuara në këto stimuj. Po njerëzit janë kafshë komplekse që e bazojnë sjelljen e tyre më tepër në përfaqësime sesa në “aktualen” siç përshkruhet nga shkenca. Kështu, Francis Jammes, kur përshkruante pyllin shkruante: “...ajo tokë e freskët, blu, ku dikush i flet shpirtit të dikujt...” dhe Lamartini shkroi: “...por natyra është atje, duke të ftuar dhe duke të dashur ty ...” Çfarë është “shpirti?”. Dhe çfarë është “natyra”? Është e vështirë ti karakterizosh ato, e pamundur mos t’i marrësh parasysh në një analizë të asaj se çfarë kërkojnë njerëzit nga pylli. Nëse njerëzit vijnë në pyll, arsyeja është për të gjetur këtë lloj sensacioni. Në shumë kultura, shpirtërimi është një shqisë, ndërmjet të tjerave: ne themi, në fakt që ne “i ndejmë” gjërat.... Shpirtërimi, protagonist në një luftë që zuri vënd në të kaluarën e afër, ku shkencat dhe fetë luftuan për të bërë një shpjegim të botës, u kundërshtua nga shkenca të ndryshme dhe shkencëtarët. Dhe megjithatë, kur feja nuk pyetet për të shpjeguar, kur nuk ngrihet kundër metodës shkencore, ajo kthehet në një fenomen natyror të pa evitueshëm në përshkrimin e jetës dhe qënieve jetësore. Dikush nuk do të donte ta zhvillonte këtë pikë, e cila në fakt ka qenë objekt i shumë debateve - të një cilësie të pabarabartë – dhe diskutimeve fenomenologjike, dikush do të theksojë faktin që ky aspekt i rëndësishëm i problemit të perceptimit human është vendosur në mënyrë logjike menjëherë në pjesën më të madhe të të ashtëquajturave analiza rationale të kryera deri tani. Dhe nëse dikush dëshiron të ketë mjetet e përshtatshme që nga fillimi për studime cilësore dhe sasiore do të bente një gabim nëse nuk do ta mernte atë në konsideratë. Pikpamja agnostike shprehet në një mënyrë tjetër, duke thënë se njeriu shkon në pyll “për të gjetur burimin e vetvetes” ose për të “prekur energjinë e tij atje”. Në mënyrë të ngjashme dikush ka arsye të pyesë se çfarë janë këto “burime”

dhe se çfarë “energjie” i referohet. Mos harroni se “ne shkojmë për të ëndërruar atje”, gjithashtu. Ai që e diskuton rolin thelbësor që pylli luan për ne, do të binte në gjurmim të gabuar të analizës së motivimeve që na çojnë atje. Pra përgjigja e pyetjes “Përse shkojmë ne në pyll?” mbetet disi e turbullt. Një shkencë e vlefshme për emrin e saj nuk mund të kënaqet me një përgjigje si “ne shkojmë për të gjetur atje gjithçka”. As menaxhuesit, që duhet të bëjnë konkrete zgjedhjet e kushtueshme, as investitorët. Menaxhuesve të niveleve të larta u pëlqen të pretendojnë se e kanë në dore pyllin, kështu ndodh edhe në muajin e pyjeve kur njerëzit e zyrave marrin edhe disa shkolla e mbjellin disa peme që shpesh nuk kanë lidhje me pyllin. Në fakt menaxheret duhet ti bindin politikeberesit se pylli vetë mbillet. Ai prodhon me shumice farë dhe habitet me këtë pretendim të atyre që e presin, kur mbidhen bëjnë marshim, hapin gropa e thonë se filluam fushatën e pyllëzimeve. Nganjëhere gabimin se pyjet do ti mbjellim ne njerëzit e bëjnë edhe të diturit. Ajo që pylli u kërkon njerëzve është që ta lenë të mbijë e të rritet, ta respektojnë kur është në këtë proces delikat të rilindjes, që ai e bën për mrekulli me farën e tij në tokën e tij. Këmba e goja e lopës, dhisë, derrit, mushkës e kalit në këto dite duhen mbajtur larg, që këto filiza të rriten. Këtë kontribut do të na kërkonte pylli, që ai si shenjtor i gjelbër që është të mundet të na shërbejë. Ka ende njerëz që shkojnë në pyll për të qeshur dhe për të vrapuar... Ka nga ata që shkojnë për “një ndryshim”(ndryshim rrethanash, të atmosferës, pamjes)... Ata që shkojnë, meqë kanë shkuar prindërit e tyre dhe përpara tyre, gjyshërit për të mbledhur lule gjatë stinës, për të gjuajtur, për të mbledhur këpurdha... Ata që ndiejnë se duan të shkojnë. Ata që shkojnë për të mësuar, identifikuar bimët, gjurmët, kafshët... Një analizë e asaj që njerëzit kërkojnë të marrin dhe japin për pyjet është padyshim e guximshme. Njerëzit e ndiejnë se pylli zgjon emocion dhe afekcion tek çdokush, që ai ka një dimension simbolik (ashtu si deti gjithashtu), një thellësi që është pjesë e fuqisë së tërheqjes dhe që nuk është në asnjë mënyrë pjesa më e vogël. Nëse këtë e marrim në konsideratë, politikëbërësit do të tregohen më të arsyeshëm kur të rishikojne e përmirëojnë ligjin për pyjet. E pakta që mund të bëjnë është të pranojnë që shenjtori i gjelbër, është shenjtor jo vetëm në varreza e vende të shenjta, ai është shenjtor kudo lejohet të rritet, bekon hidrocentralet, sjell ujë, mbron fshatin e qytetin, dhe cilësia e jetës sonë rritet nëse këtë shenjtor e lemë të jetë atje ku zoti na e dërgon si pjesë që e bën më të pasur e më të bukur atdheun tonë, në rrugën e gjatë të ëndërruar që të kthehemi nga përdorues në vizitues të këtij shenjtori që na mbron e duron gabimet tona

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

www.dibra.org

kritikë letrare

“Për prozën e Kadaresë”, një libër i ri nga Shaban Sinani

-Botim i Studios Letrare “Naimi”-

Nëpër libraritë e vendit sapo është hedhur në qarkullim libri me studime “Për prozën e Kadaresë” i Prof. Dr. Shaban Sinanit, botim i kolanës “Universitas” të shtëpisë botuese “Naimi”. Profesor Sinani njihet si një nga studiuesit më kompetentë të shkrimtarit të njohur.

Shaban Sinani, studiues dhe historian i letërsisë; etnolog, eseist dhe publicist; pas botimit të disa librave me studime historiko-letrare, mes të tjerësh: “Pengu i moskuptimit” (1997), “Sipërrore” (1998), “Mitologji në eposin e kreshnikëve” (2000, 2006), “Kështjella e virtytit” (2001), “Beratinus” (2004), “Një dosje për Kadarenë” I-II (2005), “Një Shqipëri tjetër” (2006), “Ura dhe kështjella” (2006), “Prurje


kulturore orientale” (2007), “Përveçime” (2007), ja ku ridel para lexuesit me një libër të ri, që përmban artikuj dhe studime të shkruara për prozën e I. Kadaresë gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundmë, gjatë viteve 1991-2009.

Në hyrje të librit “Për prozën e Kadaresë” Akademik Jorgo Bullo, ndër të tjera, shkruan:

“Me këtë libër Shaban Sinani dëshmon se është një zë autoritar në studimet tona dhe sidomos në studimet për Kadarenë. Libri ka për qëllim të lehtësojë një lexim shkencor të prozës së Kadaresë, sidomos prej studiuesve në formim e sipër. Por në një vlerësim më të gjerë ky libër i ri me studime i Shaban Sinanit mund të shërbejë dhe si një udhërrëfyes i saktë jo vetëm për nxënësit, studentët, filologët dhe studiuesit e veprës së Kadaresë, por, për shkak të gjuhës së shkathët dhe stilit elegant,

edhe për lexuesin e gjerë dhe dashamirësit e letrave shqipe. Mund të thuhet se kush kërkon të kuptojë dhe studiojë edhe më thellë prozën e I. Kadaresë e ka të domosdoshëm këshillimin me studimet e Shaban Sinanit dhe me këtë libër të ri të tij”.

“Shaban Sinani me studimet e tij, -thuhet më tej në parathënie, - u bë një nga aktorët e ndryshimit në mënyrën e të menduarit dhe të interpretimit të proceseve historike e kulturore të zhvillimit të shqiptarëve nga lashtësia në bashkëkohësi. Në fushën e studimeve letrare, në punën e tij, ai e zhvendosi epiqendrën në të sotmen, duke sfiduar të ashtuquajturën “teori të distancës”, si domosdoshmëri për të gjykuar drejt mbi proceset dhe produktet kulturore e letrare”, shkruan për autorin e librit Prof. Bullo.



Nga JAHE DELIA(SELMANI)

E kam ndjekur që herët talentin e tij. Atëherë ishin vitet 70 e unë jepja lëndën e letërsisë në shkollën e Radomirës. Munir Hoxha ishte nxënësi më i veçantë në lëndën e letërsisë. Isha i bindur në talentin e tij dhe nuk isha gënjyer. Me një trup të imët por të zhdërvjellët, kërcente bukur vallet e krahinës. E këtë më shumë e mori të trashëguar nga babai i tij Dali Hoxha, një koreograf amator por që mësuan dhe vetë profesionistët prej tij.

Muniri jo vetëm nga babai por mori dhe nga Misim Daku, një valltar dhe ky virtuoz, i ndjeri Tahir Skeja e Kamber Skeja.

Muniri u largua nga Radomira sapo mbaroi klasën e tetë për të vazhduar më pas shkollën ushtarake "Skënderbej" dhe më vonë "Akademikë" e Forcave Tokësore por për arsye të ndryshme nuk punoi në ushtri. Iku nga Kalaja e Dodës në moshën 15 vjeçare për t'u bërë pas një sërë vuajtjesh dhe sakrificash banorë i Tiranës por lidhjet me vendlindjen nuk i shkëputi asnjëherë

-Megjithëse nga Tejsi i bukur i Radomirës u largova me opinga llastiku gjithmonë do të gjejë mundësi që ta shikojë përsëri, më merr malli për çdo gjë të mirë dhe të bukur që mbart kjo treve e njohur. Edhe fëmijët e mi që në fakt kanë lindur në Tiranë e kanë krenari origjinën time, janë shumë miqësorë me vendlindjen time. Kujtimet për vendlindjen, për ato njerëz sa punëtor, kryelartë e të dashur, më çlodhin e duket se "mbyllin qarkun" për të vënë më mirë në punë imagjinatën, shprehet me buzëqeshjen e tij të veçantë Munyri. Pasioni për poezinë i lindi që herët, poezitë shtoheshin pa pasur një objektiv kohor botimi. Ato bashkë me tekstet e këngëve të bukura shpesh i gjeje të shpërndara në sediljen e makinës së tij. Makinë ka studion, aty ku lindin poezitë, prandaj dhe vëllimi i tij i parë titullohet me një gjetje mjaft të bukur "Mbi katër rrota". Lidhur me studion e tij "mbi katër rrota" tregon vetë Muniri një ngjarje që i ka ndodhur para pak kohësh. Një këngëtare e njohur në vendin tonë kishte kërkuar disa herë të takohet me Munir Hoxhën për të porositur një tekst kënge dhe ishte lodhur duke u interesuar se ku e ka studion. Më së fundi e gjeti afër makinës në një lokal tek po pinte kafën e mëngjezit.

-S'lashë vend pa kërkuar studion tuaj, në fakt ku e keni? Shpejt këngëtares i ranë nervat dhe buzëqeshi me keqardhje kur Muniri i tregoi studion e tij të vërtetë. Dhe vërtet kjo "studio" resht së prodhuari. Aty lindin çdo ditë poezi të reja e tekste këngësh të cilat i ka "peshqesh" nga tipa të ndryshëm njerëzish që

Njeriu dhe poeti



Munir Hoxha

udhëtojnë me makinën e tij. Dhe ja sa bukur tregon për studion e tij Muniri:

"Mbi katër rrota.

Endet jeta ime.

Mbi katër rrota

Endet shpresa ime.

Shokët dhe miqtë që u njohën me krijimet e tij të shpërndara e nxitën t'i mbledhë për botim. Ndër ta dhe më këmbëngulësi ishte poeti dhe autori i mijra teksteve Jorgo Papingji. Vetë Mynyri e quan Jorgon "mik ideal dhe ky mik si redaktor i librit, në faqen e parë, në mënyrën më lakonike shkruan: "Ka njerëz që nuk marrin përsipër të bëhen emra të mëdhenj të letërsisë së një kombi, por vetëm se ato duan të firmosin në apelin e saj të vërtetësisë". Interesat artistike të Mynyrit janë të shumanshme, bashkëpunimet e konsulentat me këngëtarë, humoristë, radio e tv janë të konsiderueshme. Ka patur bashkëpunim me Radio Tiranën në emisionin "Për shqiptarët jashtë atdheut". Nuk është as humor i jashtë gjinisë së tij duke krijuar material për humoristët si Met Bega e Marjana Kondi. I paharruar për të do të mbetet programacioni me mjeshtrin Aleko Prodani në TV Korça. Sot Mynyr Hoxha ka gati botimin e dy librave me poezi ku spikat më shumë lirikja si dhe një poemë që e merr temën para dy shekujsh. Krijimet e Mynyrit mbartin hallet e njerëzve të zakonshëm, trajtojnë tema që vetëm një krijues me nuhatje të hollë i dallon e i ngre në art, të habit me shtrimin e zgjidhjet lakonike të problemeve që shpesh nisin si rebusë të

vështira. Tek poezia "Ikja" në mënyrën më origjinale jep konceptin filozofik të ikjes e ardhjes në optikën e një poeti plot ngarkesë e ndjenjë:

"Çdo gjë që ikën lëre le të ikë.

Se pa ikje nuk ka ardhje tjetër.

Dhe vitet që mbetën t'i gdhendi në rrip.

Siç gdhend ditët një ushtarë i vjetër..."

Një gjetje shumë origjinale shihet tek trajtimi i një teme sociale që e bren një shoqëri moderne e ka të bëjë me lidhjet e gabuara e me tjetërsimin e ndjenjave:

"Çudi që puthesh me një tjetër.

Që është gjithçka e s'është asgjë

Tek të ngacmon kujtimi i vjetër

Që ishte shumë e nuk është më.

Lexuesi që e ndjek e vlerëson. Mynyri edhe më shumë vlerësime do të marrë me ato që do të botojë në të ardhmen. Vlerësime ka marrë edhe nga personalitete të letrave shqiptare kur ka kontaktuar me ta si: Xhevahir Spahiu, Adriatik Kallulli që e quajnë me plot gojën një Esenin shqiptar, apo i madhi Dritëro Agolli që i ka thënë: "Edhe më të dobëta se këto t'i bësh, je i madh. Por Mynyr Hoxha prapë nuk mburret, vlerësimet i merr për detyrim edhe më të madh ndaj vetes e të tjerëve që e vlerësojnë. Besojmë se puna do t'i ecë e do ta bëjë të madh, se interesat e tij janë të shumëanshme.

Do të ketë kohë të flitet për poezitë e tij të botuara e të pabotuara ende dhe duke e lënë të hapur këtë temë, dua të ndalem edhe tek një pasion i veçantë; kënga. Janë mbi 70 tekste këngësh të regjistruara më tepër në radio e disqe, ndonjë edhe në klip. Tekstet e tij kërkojnë nga shumë këngëtarë. Shumë prej këtyre teksteve nuk e kanë emrin e autorit në fund, por ai nuk bëhet merak, mjafton që ato të kënaqin shijet e dëgjuesve. Njëkohësisht nuk e fsheh shqetësimin qytetar kur mbi ndonjë tekst të tij vegjeton një muzikë e stisur joshqiptare dhe e kënduar nga ndonjë këngëtar dasmash. Në këto raste nuk i vjen keq që teksti i tij i bukur mbetet anonim. Për këngën ka patur konsulentca me disa këngëtarë të shquar mes të cilëve edhe me Luan Zhegun me të cilin akoma nuk ka realizuar për arsye të angazhimeve të shumta të këngëtarit. Këngëtarja e njohur Valbona Halili këndon katër këngë të Mynyrit mes të cilave spikat kënga e mirënjohur "Në derë du pajtonin" me të cilën kënga e bukur tiranëse e dasmës ngrihet në nivele edhe më të admirueshme.

Klipit të realizuar me një finesë dhe elegancë ia ngre edhe më shumë vlerat refreni:

"Në derë du pajtonin,

Supet me oriz,

Ruejma djalë fustonin,

Se mos ma bojsh pis..."

Me këngëtarin Xhavit Dedej përmendim këngën "Kjo dashnia do ustallik". Sinan Hoxha në diskun prej 9 këngësh 4 i ka nga Mynyri si: "Rina-Rina", "Shën-Valentini" etj. Me Pajtim Strugën ka këngët "E ka thanë edhe kuranin", pritret të dalë kënga "Te xhamia, te sahati" Me Elda Shabanin ka tre katër këngë si: "Mos ma shto mërzinë". Ka dy këngë dashurie me këngëtarin Rati. Me S. Miskun ka këngët "Këngë për Shijakun", "Këngë për Kavajën". Me Lirim Hoxhën, Artan Jasharin, Muharrem Ahmetin ka realizuar disa këngë në radio. Nga grupi i Çipinit-Vlorë pritret të dalë kënga "Që të tëra i ka Vlora". Petrit Lulo ka në proces këngën "O bixhoz, o qerrata" dhe Arif Vladi "Këngë për rrugën Kukës-Prishtinë"

Këngëtari Ylli Bako do të këndojë këngën "Lule çaji, lule mali" ku duket sikur në të është mbledhur për t'u shijuar aroma e tërë maleve të Shqipërisë nga Veriu në Jug kur thotë:

"Lule çaji, lule mali.

Shijen tënde ma ka enda

Për sheqer nuk më merr malli

Se sheqerin e ka brenda"

Është interesante shtrirja gjeografike e këngëve të tij. Kur shkruan këngë për Tiranën, duket si tiranas i moçëm, kur shkruan për Jugun, të duket se po bisedon me një lab apo korçar. Është një njohës i zakoneve, folklorit, dëshirave e interesave të çdo treve shqiptare e për këtë admirohet edhe më shumë nga dëgjuesit kudo. Teksti i këngës ecën paralel me poezinë e mirëfilltë. Tani kam shumë porosi, -thotë ndërsa pi kafe tek lokali i Arianës, një grua fisnike që, kur e sheh Mynyrin në "ethet" e krijimit, plot mirësjellje u thotë edhe të tjerëve që të mos e trazojnë. Dhe me një vështrim disi të përhumbur vazhdon "Por ka edhe raste kur vërtet vihem në siklet, kur ndonjëri më kërkon një këngë që t'i përshtatet një melodie të caktuar dhe atëherë më kujtohen fjalët e kompozitorit të madh Çesk Zadeja në një takim kur për të tilla raste tha: Është njëllloj sikur të bësh këmbën sipas këpucës e jo këpucën sipas këmbës"

Kur rri e qëndron me Mynyr Hoxhën nuk ke humbur kohë, por ke fituar. I larguar herët nga Radomira, nga goja e tij dalin fjalë, histori e kujtime të një kohe të shkuar, që tani ngajnë si fosile e vlejné të studiohen, sepse tek Mynyri janë konservuar si në një arkë të sigurtë. Jetojnë bashkë tek ky njeriu dhe poeti.

Vargjet e sipërme i mora nga dorëshkrimi i parë “Mbresat e mia në vargje”, libër që i kalon të dyqind faqet. Malli për vendlindjen dhe njerëzit u bëka edhe penë, e bëka njeriun edhe poet, edhe shkrimtar, edhe...

emigracion

MALEVE TË REÇIT ME FAIK PRENÇIN...

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Me të, me Faik Prençin nga Reçi i “Nëntë Maleve të Dibrës”, herë-herë pimë nga një birrë, shqeto, drejt nga shishja...

Pimë dhe me mendje fluturojmë maleve. Ndalemi në Reç dhe potkojmë fshatrat siç potkohen lulet në Shëngjergj duke u hedhur sipër troshka buke, vezësh e të tjerë ushqimesh duke mëmëritur nën zë ritet e lash-ta:

O na erdhi vera
Me dhen e me shqera...

Pimë dhe fluturojmë në Çidhën, hyjmë në histori duke tundur bedenat të moçëm që lidhen me Çidhnën e Skënderbeut dhe bedena të rinj që lidhen me tunelet e Gjalicave, hyjmë edhe në klasat e shkollës në majë të një çuke natyrore që ta merr shikimin e ta përplas sa Grykë Nokës aq edhe Sinave teje e tej në theqafje të natyrës, hyjmë dhe ai kërkon e më nxjerr deferin e kujtesës me emra e adresa të nxënësve të tij...

Pimë birrë me mendjen tek burimet e Sopanikës në atë varje gjerdanësh me perla... Pastaj ai nxjerr një fletore ku me një shkrim të bukur e me një shqipe të pastër më ve në kujtesë jetën dhe brengën e tij në vargje.

Prej asaj fletoreje, që shpresoj një ditë të bëhet libër, këputa disa rreshta siç këputen e bëhen tufë lulet e majit...

E ka një merak të madh Faik Prençi, atë merak që e kam edhe unë, ndaj kam bërë edhe një libër-“Rilindësit e kohës sonë”, merakun e gjuhës, të asaj gjuhe të bukur që nuk ia lëshoi bedenat kërkuat në histori...

Udhëtoj disa herë,
Nga Athina në Tiranë.
Përveç timonierit,
Të tjerët...
Shqiptarë janë.

Në të folur
As fëmijët
Që kanë pranë,
S’më ngjasojnë
Në gjuhë,
Si shqiptarë.

Pesë shekuj
Arbëreshët në Itali,
Arvanitët në Greqi,
Akoma...
S’e kanë harruar,
Gjuhën mëmë,
Që nga koha
e Skënderbesë !...

Mësojani fëmijës
Gjuhën MËMË !

E donë fjalën shqipe, e kërkon në shtëpi, në rrugë, në kafene. E kërkon dhe kur e gjen tabaku që mban filx-



Abdurahim Ashiku me Faik Prençin

hanin e kafesë, i argjendte i duket...

Me frikë futesha
në kafene,
për një kafe
në lokalet greke,
gjuhën nuk e dija.

Rastisi
një ditë,
në një lokal,
një çift shqiptar

E argjend
mu duk
ajo tabaka,
kur më sollën
kafenë
në gjuhën time.
E më pyetën
për shëndetin
e gjithçka.

Këtu do ta pi,
Gjithmonë kafenë !

I dhemb ikja, farë e shpërndarë, a si i thonë në një fjalë bote me rrënjë të greqishtes së lashtë – diasporë, i dhemb ndaj thërret me zë...

Nuk u shpërndamë,
si shpërndan
Bujku
farën në arë

Bujku e shpërndan
farën në një arë.
Ndërsa ne...
Në gjithë Botën
Mbarë,

Në arën e bujkut
mbin e njëjta farë.
Prej arës “Botë”
mbin,
vetëm mall !

Mall për njeri tjetrin
Mall për vatanin !

Plagë të shumta ka në shpirt Faik Prençi i Reçit, plagë që lidhen me mëmëdheun, me Dibrën, me vendin ku lindi, u rrit dhe mërgoi... për të mërguar përsëri...

Dhe thotë zemërlënduar...

Kur e krahasoj sot,
Hartën e Shqipërisë
Me atë të Skënderbesë,
Më duket...
Si kokë lejteku,
Kur ulet në ujërat
E kënetës.

Pse veç dy këmbë
Me një kokë, ke ti ?
Po brinjët e krahët
Ku mi ke ? (Ah!)
Ca në Kosovë,
Ca në Maqedoni,
Ca në Mal të Zi,
Ca në Serbi
Ca në Çamëri !

Kështu e copëtuar
Më dukesh
E shëmtuar....!

Merre guximin
Pa pyetur,
Kërkënd në botë
Dhe bashko trupin
E plotë.
Të mos mbetesh lejlek
Në kënetë
Po shqipe malesh
Me kokë
Këmbë
E fletë !

Atëherë je
Harta e vërtetë !

Për të vazhduar më tej me thirrjen...

Ca gjuhë prishur
Thanë ahëre :
Dibra e Vogël,
Dibra e Madhe

Mendjeshkurtrit
Në dy pjesë
- Plakushët e Evropës
Dëng,
Me kufij në mes...

E “vogël”, e “madhe”
Dibra “NJË”
Vëlla i mirë

Për gjithë
Shqipërinë

Dibrani,
vetëm
E ka pastruar
Oborrin e tij...

Atë që ka në zemër, në shpirt, atë që përbën thembrën e jetës së emigrantit ai e thotë...

Cilido duhet
Të thotë:
Shqipërinë
S’e ndërtojnë,
S’e mbrojnë
Ata që i mbajnë
“Gajlen”
- Harroje !

“Gajlen” mundet
Ta mbajnë
Dhe të huaj,
“Gajle” mbetet
Për të tërë.
- Harroje !

Ta zhvillojnë
Mbrojnë,
Janë:
Bijtë e bijt’ e shqipes,
Që duan me zemër
Shqipërinë,
Kudo që janë !
- Pranoje !

Faiku është emigrant, pa letra, është i “burgosur i pandreqshëm”. Edhe kur grekët hapin derën e “burgut” ai nuk lëviz dot, nuk ia kanë dhënë as “veveosin jeshil”. Grekët, pleqve, prindërve të fëmijëve të rritur, nuk u japin leje qëndrimi. Nuk u japin as sigurim shëndetësor, as... Ndaj ai thërret:

O emigrant!
Mendoju
Me gishtin
Kokës,
Të mos tallen
Njerëzit e botës !

Me para e merr
Gatimin e huaj ?
Më e ëmbël buka,
Në vendin tuaj !

Çidhna ku për shumë vjet në rininë e tij mësonte fëmijët e vegjël kishte një shkollë...

Dhe ishte shkollë... Nga kjo shkollë ai ka marrë me vete shumë “leksione”, njërin prej të cilëve e ka vënë në vargje...

Sa të ngjitësh
Maloren e fortë
Në Arras të Dibrës
Për në Grykë Nokë
Tek Varri i Jovanit,
Pushojmë
Ndërrojmë cigare
E bisedojmë

Mbi varr

Lisi me myshqe
Ngjyrë gri
Si flokët e mustaqet
E tij.

Grykë nga malet
Nokë nga trimat
E Jovanëve

Gjithë Çidhnakët
Jovanë janë
Në çdo betejë
Trima, kapëdanë...

Faiku është gjysh, disa herë gjysh. Kjo e gëzon, ja dredh telat e zemrës, ndaj...

Një ditë, njëherësh
më erdhën
tek tavolina
e shkrimit,
nipat e mbesat
të lindur në Greqi:

Eltoni,
Kleloa,
Xhesi,
Sara,
Rigelsi,
E pipirruqja - Siena.

Zemra më gufoi
nën shpirtin e qetë,
kaq herë
gjysh u bëra.

Nënat duan
t’i largojnë.
Ikën....nënat,
se i pashë,
me inat!

S’jam i qetë
kur s’i kam pranë.
Njomëzat
mjaltë mbi mjaltë.

Faiku këto ditë, ndërsa pinim birrën e zakonshme drejtpërdrejt nga shishja, shqeto, nxori nga xhepi i brendshëm i xhupit një fletore...

-Lexoje, më tha, por mos e shkruaj në kompjuter, vetëm lexoje...

E di pse thotë “mos e shkruaj në kompjuter”...

Po e lexoj...
Po e shkruaj...

Janë të tjera vargje, të tjera ndjenja për vete, për shokët, për miqtë, për Atdheun...

Vargjet e sipërme i mora nga dorëshkrimi i parë “Mbresat e mia në vargje”, libër që i kalon të dyqind faqet.

Po kaq i bie të jetë edhe volumi i dorëshkrimi të dytë...

Malli për vendlindjen dhe njerëzit u bëka edhe penë, edhe kompjuter, e bëka njeriun edhe poet, edhe shkrimtar, edhe...

Malli për vendlindjen ka nxjerrë në orbitën shqiptare poetë e shkrimtarë të mëdhenj...Naimi, Samiu, Mjeda, Shiroka, Pashko Vasa, Noli...

Athinë, prill 2009
a_ashiku@yahoo.gr

Pajtohuni në gazetën “Rruga e Arbërit”

E-mail: rrugaearbërit@gmail.com. Tel.
www.dibra.org

Në kujtesën e tërë atyre që e njohin i ndjeri Shehat Marku mbetet një intelektual, gjykatës i ndershmë, patriot dhe publicist i dalluar në shtypin shqiptar në Maqedoni dhe Shqipëri.

In memoriam

Shehat Marku, një jetë në shërbim të kombit

Më 27 mars 2009, në moshën 70 vjeçare u nda nga jeta intelektual, gjykatësi dhe publicisti dibran Shehat Marku, i shquar për punën e tij të palodhshme në ruajtjen e sdrës, arsimimit dhe intelektualitetit dibran.

Shehat Marku u lind në Dibër, shkollën katërvjeçare e kreu në fshatin Bohmovë, tetëvjeçaren në Dibër, të mesmen Normale në Shkup. Punoi si mësues në rrethin e Pollogut dhe sidomos në Çegran ku dha kontribut të madh në arsimimin e brezave të rinj. Fakultetin juridik e filloi në Beograd dhe e përfundoi në Zagreb ku ishte student i dalluar. Në Zagreb ishte themeluesi i parë i Shoqatës studentore patriotike "Shkëndia". Pas mbarimit të studimeve punësimin e parë e filloi në gjykatën e Prizrenit në Kosovë, sepse Dibra ende ishte e molisur nga kthetrat e Rankoviqit. Ishte kodi lidhës i juristëve të dalluar të Kosovës, por nuk pranoi ta vazhdojë karrierën e tij atje sepse mendjen e kishte të vendlindja dhe vizioni i kombit shqiptar në Maqedoni. Prandaj u kthye të punojë në Gjykatën komunale të Dibrës derisa doli në pension. Ishte lidhur shpirtërisht me ndërtimin e "Rrugës së Arbërit" që lidh trojet shqiptare. Kontribuoi në themelimin e statusit të Universitetit të Tetovës. Motoja e tij ishte flamuri, ndërsa feja e tij ishte shqiptaria. La amanet bashkimin e trojeve etnike shqiptare. Besonte në gjakun arian të shqiptarit. Ishte djali i Kaloshit dhe nënës Kadrije Toçi. Kur Shehati ishte gjatë vjeç kjo familje u internua në fshatrat e Maqedonisë lindore sipas projektit serbo-madh antishqiptar. Vdiq i qetë sepse Kosova u bë shtet më vete. Besonte se shqiptarët e Maqedonisë nëpërmjet partive shqiptare në kauzën e tyre



duhet të kenë kombin. Ndjente kënaqësinë më të madhe atëherë kur liderët partiakë shqiptarë i shtrëngonin dorën njëri tjetrit. Shehati ishte bashkëshorti i Fatimes, profesore e gjuhës shqipe, baba i Fisnikut, inxhinier i dipl. i informatikës, i Adelins, mjeke e diplomuar dhe analiste, dhe e Parimit, i diplomuar në biznes dhe administratë. Ishte gjyshi i Nesës, Lekës dhe Andresh dhe vjehri i Mertës dhe Vetonit.

Shpëtim Cami, kryetar i Shoqatës qytetare "Votra Dibrane", në nekrologun e tij gjatë varrimit, u shpreh se: "Ikja jote në botën tjetër na hapi plagë të thellë të gjithëve që të njihnim. Ishte prind dhe familjar i mrekullueshëm, gjykatës i preferuar i së drejtës të pakontestueshme dhe ata që e shijuan dhe e përjetuan këtë do ta mbajnë mend për jetë dhe me pietet. Ishte një punëtor i palodhur shoqëror sidomos për realizimin e aspiratave për Dibrën, vendlindjen tënde që e adhuroje dhe punoje me ngulm dhe thojë se Dibrën tonë nuk duhet ta lëshojmë prej dore, Dibrën e lashtë, Dibrën e mençurisë, trimërisë, Dibrën e bëmave historike. Ty ishte themeluesi i Shoqatës qytetare "Votra Dibrane", që e vendose

mbi platformën patriotike, duke afruar rreth saj edhe bashkëatdhetarët tanë në SHBA, diasporën në Evropë, në përpjekje për pengimin e mërgimit, me dëshirën për të mos e harruar vendlindjen dhe me synimin për krijimin e kushteve për kthimin sërish në vendlindje të mërgatës sonë. Do ta ruajmë gjallë kujtimin për Ty, sepse Ty ishe kryetari i parë edhe i SHKA "Liman Kaba" në vitet e 60-ta të shekullit që lamë pas, e cila edhe pse e pëmdjekur nga qarëet shoviniste, ringjalli jetën kulturore në Dibër, Maqedoni, në Kosovë e diasporë. Ty ishte nxitës, nismëtar dhe realizues i veprimtarisë së Shoqatës së intelektualëve shqiptarë të Dibrës dhe Maqedonisë, ku ishe anëtar shumë produktiv i Këshillit republikan. Ty ishe i tëri me plane dhe aspirata progresiste për të ardhmen tonë dibrane, kombëtare e njerëzore. Ne sot po ndahemi me lot në sy dhe me mirënjohjen tonë shpirtërore për tërë atë bërë. Të qoftë e lehtë toka dibrane që e adhuroje tërë jetën".

Jakup Marku, në nekrologun e tij në emër të fisit Marku, shtoi se: "Ne brezave të ri Ti gjithnjë na qaseshe si prind dhe tërë jetës iu përkushtove mësimi dhe dijes. Kurrë nuk lejove që si gjykatës në përcaktimin e të drejtës të influencohesh nga politika e kohës.

Në kujtesën e tërë atyre që e njohin i ndjeri Shehat Marku mbetet një intelektual, gjykatës i ndershmë, patriot dhe publicist i dalluar në shtypin shqiptar në Maqedoni dhe Shqipëri.

I ndjeri Shehat Marku, u varros të premten në praninë e familjarëve, fafesisit dhe shokëve e miqve nga Dibra, Kosova, Shqipëria dhe shumë qytete të Maqedonisë.

Ndahet nga jeta veterani Din Çera

Më 9 prill 2009 vdiq veterani i luftës Din Halit Cera. Ai lindi më 1 nëndor 1926 në fshatin Trojak të rrethit Dibër. Gjatë viteve 1933-1937 mbaroi shkollën fillore në Palaman me rezultate të mira. Pushimin e Shqipërisë nga Italia fashiste e priti me indinjatë ashtu si shumë bashkëmoshatarë të tij. Kur u krijua brigada e 18 sulmuese në Sllatinë, atëherë vetëm 18 vjeç djali Din Çera u rrjeshtua ndër të parët në batalionin e parë të kësaj brigade. Siç tregojnë bashkëluftëtarët e tij Dini ishte ndër aktivistët kryesorë të këtij batalioni që u dallua në aksionet luftarake të kësaj brigade si në Kukës, Prizren, Zhur, Kala e Dodës. Dini ishte ndër delegatët e parë nga brigada e 18 që do të merrte pjesë në kongresin e rinisë antifashiste. Pas kongresit Din Çera caktohet në prapavijën e Divizionit të pestë në Gjirokastër. Fill pas çlirimit të vendit Dini kthehet në Peshkopi ku në fillim filloi punë si financier në bankën e shtetit.

Vetëm pak vite më vonë dërgohet nga rrethi i Dibrës në Shkodër për të ndjekur një kurs infermierie.

Për 15 vite me radhë Din Çera do të kryente detyrën e kryeinfermierit në dispanserinë e Peshkopisë. Me hapjen e spitalit të Slllovës Dini do të transferohej nga Peshkopia për të ardhur në Sllovë si kryeinfermier deri sa doli në pension. Ai në fakt kishte profesionin infermier por nga praktika e gjatë kishte përfutur shumë. Ai u kthye në një mjek i vërtetë me zemër të madhe. Do ta gjeje në gadishmëri të plotë në të gjithë zonën që nga Kalaja e Dodës e deri në Dypjakë, Nga Shumbati e në Çidhën. Kudo kur e kërkonin ai ishte i përtuar dhe u gjendej pranë të sëmurëve. E dibranët do ta kujtojnë gjithmonë si një ndër njerëzit më të përkushtuar që u dha ndihmën e parë në momente të vështira. Din Çera ishte dekoruar disa herë. Ai mbante medaljen e çlirimit, të trimërisë. Jo vetëm kaq por Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekret 6960 datë 6.



4. 1985 i jep Din Çerës medaljen e punës me motivacion: "Për shërbim të mirë ndaj popullit"

Selim Pira, Hysen Çera, Halil Robi, Ferit Çera, Esat Skarra, Bazri Çera.

TË QESHIM SË BASHKU

MJEKRA E MYFTI BANUSHIT

Nga: **NAIM PLAKU**

Kishte pasë jetuar në anët tona kohë më parë një djallë që thoshin se kishte mbaruar medresen në Stamboll dhe, si të tillë, e zgjodhën myfti. Erdhën si erdhën punët dhe këtij myftyut na i doli boja pa mbushur mandatin e tij, siç ishte mandati i myftyut të atyre kohërave, apo siç është dhe sot mandati i deputetëve tanë.

Në takimin e parë që bëri një ditë të xhuma në xhaminë më të madhe të krejt qendrës së krahinës, ku qenë mbledhur shumë besimtarë, myfti Banushi u hyri fort për zemër, u foli për gjërat e shumta që do të bënte për krejt zonën, për disa xhami që do të ndërtonte në fshatra, për çeshtjet që do t'i gjykonte me paanësinë më të madhe, për drejtësinë që do të vendoste kudo, për ndihmat që do t'u jepte nevojtarëve nga të ardhurat që kishte komuniteti mysliman. Premtoi e premtoi shumë gjëra duke folur dhe për moralin e tij të lartë që e karakterizonte.

- Tani kemi gjetur, vërtet njeriun që na duhet. - tha njëri.
- Ky qenka tamam myfti, njeri i Zotit dhe jo si ai kopuku që patëm më parë, që na ngopi me rrena e na la në batac.
- Lëre!- ia priti tjetri, - por kishte qenë dhe i panomuz. Ky qenka shpirt njeriu...

Por kaluan vite dhe myfti Banushi s'po bënte asgjë nga ata që tha ditën e parë. Bile thoshin se me paratë që kishte komuniteti ai ndërtoi sarajet e tij, bleu një kope me dele, filloi të blinte ca toka të majme, që i shinin fukarenjtë e fshatit dhe u bë më i pasuri në tërë krahinë. Mori tri gra nga vajzat më të bukura që kishte nuhatur andej këtej, sepse ashtu ia lejonte feja dhe pa ç'pa vendosi që të udhëtonte për në Mekë ku, i mbuluar me mahramin e bardhë do të kryente ritet një pas një për të marrë pastaj titullin Haxhi.

Dhe kështu bëri. U mor vesh në gjithë krahinë se myftiu u nis për në haxhillëk dhe, kur u kthye, i shkuan shumë vizitorë për t'i shprehur urimet:

- T'u shtoftë ymri, o Haxhi Banushi! - i thoshin. - E gëzofsh mjekrën! Haxhiu priste e përcillte vizitorët dhe u shpjegonte atyre se ç'kishte parë në Mekën e famshme. Filloi të shkruante dhe nuska e të bënte duva për t'u bërë mirë të sëmurëve e hallexhinje.

Por Haxhiu i bëri katër vjet dhe sipas rregullit do të zgjidhej prap, do ta përsëriste mandatin e tij, siç do të thoshim ne sot për deputetët. Dhe doli para xhematit të tij për të përsëritur mandatin.

Tashmë Haxhi Banushi kishte ndërruar pamje. Nuk ishte më ai myftiu i ri, me një pamje të freskët e tërheqëse, por një mesoburrë më një mjekër të zezë e konture që tregonin se kishte bërë një tualet tyë përsosur.

- Ja ku jam, - tha Haxhiu, - S'kam ç't'u them se më njihni e ju njoh.

- Unë nuk po të njoh. - u hodh e tha një burrë nga dyzetësh. - Je bërë haxhi. E ka marrë vesh tërë krahina, por do t'ju bëja një pyetje...

- Urdhëro e fol, Myftar! - foli si me të qeshur Haxhi Banushi.

- Këtë mjekër që ke lënë, vërtet të bukur e paske, por a e ke lënë në atë krye që ke poatur, apo në një krye tjetër?

Filluan të qeshin të tjerët.

- Një faqe ka burri, o Myftar. - u përgjegj Haxhiu urtë e butë.

- Po e pate lënë në atë kokën që ta njohim mirë e bukur të gjithë, ma mirë hiqe se nuk na hyn në punë...

- Banush, Banush! - thirri një tjetër nga mesi i turmës, - Mjekrën tënde s'ta do më askush. Ke vënë një mjekër në fytyrë të vjetër... Hajt, merr rrugën, o babaxhan, se myfti nuk bëhesh më. Ndërro mjekër e bëju tjetër!

**Pajtohuni
në gazetën
"Rruga e Arbërit"**

Tel. (04) 22 33 283.

E-mail: rrugaearbërit@gmail.com.

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

www.dibra.org

Meremja poeteshë, e fton lexuesin të ndihmojë të varfrit, t'u jap krahë ëndrrave dhe dëshirave për një botë më të mirë dhe humane, për më shumë përkujdesje, dashuri dhe respekt, sepse, siç shprehet ajo, "e drejta e njerëzve, është një monedhë e artë".

Mereme Suli, "Dialog me lulen"

Nga: **VIRON KONA**

Pas librit të parë me poezi: "Falni mirësi, o njerëz", ky është libri i dytë i poeteshës Mereme Suli. Si redaktor, kam kënaqësinë ta përshëndes dhe ta urojë Meremen për mbarësi në udhën e saj të jetës, të poezisë, të këngës, të humanizmit dhe të dashurisë për gjithçka të mrekullueshme që ajo ëndërron dhe dëshiron.

Udhë e poezisë është e gjatë dhe shoqërohet me arritje dhe vështirësi, ajo është një udhë ku, poetesha ende e vogël, përmes vargjeve të freskët, fton me ndjenjë e singëritet edhe lexuesit që të ecin bashkë me të, i fton ata të shijojnë bashkërisht bukurinë e jetës, të përjetojnë ndjenja dhe emocione të rralla, ta duan të mirën dhe të bukurën dhe ta përhapin atë si aromë luleve, si flladet e freskët, ashtu siç dhe dallëndyshet, përhapin lajmin e ardhjes së pranverës:

*Ja tek po vjen, dallëndyshja lajmëtare,
Dhe na sjell lajmin, dritare më dritare.*

Por, poetesha me vargjet dhe figuracionin e thjeshtë që përdor, mbanë edhe qëndrim ndaj të keqes që, ashtu si hithrat dhe ferrat, i dalin njeriut përpara dhe përpiqen t'i zënë rrugën. Ajo e di se në jetë qëllon të ndodhesh në vështirësi dhe të përballësh me udhëkryqe, ku duhet të bësh zgjedhjet mes të mirës dhe të keqes, mes të bukurës dhe të shëmtuarës, mes të lehtës dhe të vështirës, mes ëndrrës së magjishme dhe realitetit të ashpër, mes dashurisë dhe urrejtjes... Me shembullin dhe vargun e saj, ajo është e vendosur për të arritur qëllimin që i ka vënë vetes, t'u falë njerëzve, fëmijëve dhe të rriturve, ndjenja të

çiltra dhe të sinqerta, dashuri, humanizëm dhe mirësi:

*Sepse për të dyja, vlerë s'kishte pasuria,
Por dashuria, mirënjohja dhe miqësia.*

Duke shfletuar librin e ri poetik: "Dialog me lulen", jam ndjerë i entuziazmuar nga mendimet e qarta, të shprehura bukur dhe me hijeshi, me vargun dhe rimën e përdorur, me strofën dhe figuracionin, me ritmin dhe melodinë e poezive:

*Librat janë gjithçka për mua,
Me dritën e tyre, udhëtoju ku të dua.*

Në vargje dhe poezi profilizohen karaktere, përshkruhen në mënyrë poetike tipa dhe personazhe të larmishëm. Meremja poeteshë, e fton lexuesin të ndihmojë të varfrit, t'u jap krahë ëndrrave dhe dëshirave për një botë më të mirë dhe humane, për më shumë përkujdesje, dashuri dhe respekt, sepse, siç shprehet ajo, "e drejta e njerëzve, është një monedhë e artë". Poetesha, u tërheq vëmendjen lexuesve që të tregojnë më shumë kujdes për gjithë gjallesat, të cilat kanë edhe ato të drejtën ta jetojnë jetën nën rrezet e diellit që u takon, ndërkohë që, përpiqet të tregojë me finesë luftën për ekzistencë së jetës, ajo e shpreh me talent tek poezia "Shqiponja, miu dhe gjarpri", e cila nuk është thjeshtë vetëm një poezi, por edhe një fabul me përmbajtje alegorike:

*Gjarpri, duke u përdredhur, u lutej papushim,
Të mos e hanin, se në jetë kishte bërë vetëm mirë,
Por, ishte e kotë, shqiponja dhe zogjtë nuk e dëgjonin,
Edhe atë drekë, një gjarpër po shijonin.*

Poezitë e këtij vëllimi shprehin dashuritë pa mbarim për njerëzit më të dashur të poeteshës, për prindërit që e duan aq shumë, gjyshërit, që i falin veç dashuri e ngrohtësi, të afërmit, shoqet dhe shokët e shkollës, mësuesit dhe të gjithë njerëzit e mirë që punojnë dhe përpiqen pareshur për ta bërë gjithnjë e më të bukur jetën në gjithë rruzullin tokësor. Vargjet e Meremes janë të ndjerë, plot kolor e hijeshi, plot mbresa dhe emocione. Ato shpërndajnë në hapësirën letrare erën e lirisë, bukurinë e natyrës, keqardhjen për viktimat e Gërdecit, për pyllin e djegur që, si njeri, lëshon britma nga dhembjet e djegies, teksa banorët e tij të përhershëm, gjallesat e pyllit, largohen pa ditur ku të shkojnë:

*Zogjtë fluturonin, duke qarë të tmerruar,
Nga flakët e zjarrit, që s'kishin të shuar.*

Poetesha u drejtohet njerëzve me thirrje të zjarra që të ndihmojnë të varfrit, kërkon prej tyre më shumë paqe dhe harmoni, ngrohtësi dhe dashuri njerëzore, teksa demaskon të keqen, gënjeshtren, mashtrimin dhe ligësinë. Zemra e saj e njomë, plagoset kur dëgjon për njerëz që duan t'u bëjnë keq të tjerëve, prandaj, nga njëra poezi tek tjetra, ajo shpalos ëndrrat e saj të zjarra për jetën, për të bukurën, për të mirën dhe madhështoren, dhe, si një e rritur, përpiqet të japë edhe rrugëzgjdhjet, të tregojë me shpirtin saj fisnik se ku duhet të shkojë dhe si duhet të veprojë njeriu për ta jetuar jetën ashtu siç duhet:

*Edhe pse ndonjëherë, ndeshim vështirësinë,
Me guxim të ecim, të tregojmë zotësinë.*

Ndihem optimist dhe i ngazëllyer që poetesha Mereme Suli, ende e vogël në moshë,

Mereme Suli Dialog me lulen



por jo në mendim, premtom të ardhme letrare. Në shpirtin saj vezullojnë shkëndija të zjarra, që shpejt, besoj, se do të ndezin një yll të ndritshëm poetik:

Si zog krahëhapur, dëshiroj të fluturoj në hapësirë,

Botën e madhe ta përshkojë, gjithë gaz e dëshirë.

I urojë suksese dhe arritje të tjera Meremes në udhën e mrekullueshme të poezisë, ku tashmë ajo po udhëton e sigurt!! E ardhmja e saj poetike, qoftë gjithë gaz e hare, guxim, vendosmëri e besim.

Botohet për herë të parë në formë të plotë libri "HISTORIA E SHTETIT, SHOQËRISË DHE QYTETËRIMIT OSMAN"


Perandoria Osmane në vështrim shumëdimensional

Botimi origjinal turk u publikua në dy vëllime (1994 dhe 1998) dhe mbulon periudhën nga themelimi i principatës osmane, deri në shpallje e Republikës së Turqisë. Këto vëllime u përkthyen dhe botuan në arabisht në vitin 1999, në anglisht në vitin 2002 dhe së fundmi, falë punës këmbëngulëse të AIITC, ky libër vjen edhe në gjuhën shqipe.

Për herë të parë në gjuhën shqipe, pas suksesit të jashtëzakonshëm në vende të ndryshme të botës, vjen vepra "Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman" në dy vëllime.

Ky libër botohet nën përkujdesjen e veçantë të Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam (AIITC) dhe hedh dritë plotësisht mbi historinë e Perandorisë Osmane. Të shkruash mbi historinë e një perandorie të madhe, e cila përmblo dhi shumë shtete në qendër të tre kontinenteve dhe mbikëqyri rrugët ndërkombëtare për më shumë se 500 vjet, është njësoj si të shkruash historinë e botës.

Libri "Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman" është hartuar nga një grup historianësh turq, ku vlen të përmendësh disa nga emrat më të shquar të studimeve historike, si: Prof. dr. Ekmeleddin İhsanoglu, Prof. dr. Feridun Emecen, Prof. dr. Mehmet Âkif Aydın etj. dhe është përkthyer në gjuhën shqipe nga AIITC. Ky grup ekspertësh ka inspektuar arxivat e pasura në thellësi dhe ka nxjerrë në pah elementë të rinj të pikturës historike. Pa dyshim që kjo punë kolosale, ka regjistruar një hap



shumë të rëndësishëm, që meriton vëmendjen e duhur nga lexuesit.

Autorët, për hartimin e librit, përdorën burimet e arkivave, kronikat osmane, studimet e historianëve bashkëkohorë, si dhe burimet perëndimore. Synimi i librit është prurja e një perspektive të re, duke u bazuar në informacion objektiv dhe në

besueshëm nga kërkimet e fundit shkencore. Libri nuk përmban përfaqësimin klasik të kronologjisë në historiografi me përshkrimet e ngjarjeve gjatë sundimeve të sultanëve. Përshkrimet jepen vetëm kur është e nevojshme. Gjithçka paraqitet në mënyrë analitike, në përpjekje për ta shpalosur të plotë subjektin dhe në

të njëjtën kohë, për të përcaktuar lidhjen ndërmjet shkaqeve dhe pasojave të ngjarjeve politike. Nuk bëhet thjesht paraqitje faktesh, por qartësohen dhe shpjegohen me baza argumentuese institucionet e civilizimit osman, duke pasur si pikësynim përshirjen e të gjithë Perandorisë Osmane, pa përjashtuar Anadollin, Rumelinë dhe Arabinë. Studiues të njohur, specialistë në fushat e tyre, shkruajnë artikuj në këtë libër. Secili nga këta kapituj mund të ishte një libër më vete. Gjithashtu, jepet ecuria e historiografisë dhe shpaloset realiteti osman në tërësi, sepse brenda çdo periudhe pasqyrohen pikëpamjet politike, shoqërore dhe shkencore. Shumë nga të dhënat dhe informacionet konkretizohen edhe me imazhe e miniatura, me qëllimin për të përcjellë sa më qartë përmasat e Perandorisë Osmane.

Përveç zhvillimeve politike, është trajtuar gjerësisht struktura sociale, ushtarake, studimore dhe e organizimit administrativ, por pa lënë mënjë aspektin ekonomik, tregtinë dhe industrinë apo jetën shkencore dhe atë kulturore. Sigurisht, që për të shkruar historinë e një shteti që ka sunduar për më shumë se pesë shekuj dhe që bashkoi shumë shoqëri të ndryshme duke respektuar kombësinë, besimin, kulturën dhe gjuhën, është nevojitur punë kërkimore shumë e gjerë dhe përpjekje të stërmëdha. Është pothuajse e pamundur që një person i vetëm të përfundojë një studim të këtyre përmasave, duke kërkuar burimet e

rëndësishme osmane dhe perëndimore. Pa dashur të nënvlerësojmë përpjekjet individuale të historianëve të ndryshëm, theksojmë se libri i historisë osmane duhet shkruar nga një skuadër e organizuar dhe efektive, në vend të një individi të vetëm, i cili disponon mjete dhe mundësi të kufizuara.

Botimi origjinal turk u publikua në dy vëllime (1994 dhe 1998) dhe mbulon periudhën nga themelimi i principatës osmane deri në shpalljen e Republikës së Turqisë. Këto vëllime u përkthyen dhe botuan në arabisht në vitin 1999, në anglisht në vitin 2002 dhe së fundmi, falë punës këmbëngulëse të AIITC, ky libër vjen edhe në gjuhën shqipe. Së shpejti ky botim do të kristalizohet edhe në gjuhën ruse e boshnjake.

Vëllimi i parë trajton organizimin politik, historik, administrativ dhe ushtarak, si dhe sistemin ligjor, ekonominë, financën dhe strukturën sociale osmane. Ndërsa vëllimi i dytë i librit trajton jetën fetare, gjuhën së bashku me letërsinë, historinë e artit dhe arkitekturën, jetën intelektuale, arsimimin dhe fushën shkencore.

Kritika bashkëkohore ka shprehur vlerësim maksimal për nivelin e këtij libri, kjo vërtetohet edhe në pasthënieën e përgatitur nga studiuesi Halil İnalcık. Ky botim përmbush nevojën për kërkime të reja në historinë osmane, si dhe hap horizonte për studime të mëtejshme në këtë fushë. Gjithashtu lexuesin e thjeshtë e pajis me fjalorin e plotë informues mbi shtetin dhe civilizimin osman.